

MENSTRUACIONET dhe LEHONIA

*"Kapitulli i menstruacioneve dhe lehonisë" shkëputur
nga shpjegimet e Ibn Utthejminit në librin e
medh'hebit hanbeli "Zad el Mustekni'i"*

Menstruacionet dhe lehonja

“Kapitulli i menstruacioneve dhe lehonisë” shkëputur nga
shpjegimet e Ibn Uthejminut në librin e medh’hebit hanbeli
“Zad el Mustekni’i”.

KAPITULLI I MENSTRUACIONEVE DHE LEHONISË

*Shkëputur nga shpjegimet e Ibn Utthejminit në librin e medh'hebit hanbeli
“Zad el Mustekni”i”.*

Përkthyes: Genc Plumbi

Arti grafik: Armida Plumbi

Botues: Jehona

© Të drejtat e botimit janë të rezervuara.

Tiranë, 2020

MENSTRUACIONET DHE LEHONIA

Shkëputur nga shpjegimet e Ibn Uthejminit në librin e medh'hebit hanbeli “Zad el Mustekni'i”.¹

Ky kapitull është një nga kapitujt më të vështirë të jurisprudencës islame dhe për këtë arsye juristët myslimanë janë zgjatur në shtjellimin e tij.

Por mesa shohim, për ne ky kapitull nuk ka nevojë për një shtjellim të tillë, për degëzime dhe rregulla të shumta në të cilat janë përfshirë juristët – Allahu i mëshiroftë! – ku një pjesë e madhe prej këtyre degëzimeve dhe rregullave nuk kanë qenë të përcjella prej sahabeve – Allahu qoftë i kënaqur me ta.

Pra, nëse gruas i vijnë menstruacionet, ajo e lë faljen e namazit dhe kur pastrohet prej tyre, ajo falet dhe në rastet kur nuk është e qartë, ajo nuk i konsideron ato menstruacione.

Pra, rregullat e vendosura nga Suneti Profetik janë shumë të thjeshta dhe për këtë arsye hadithet e përcjella në lidhje me këtë tema janë të pakta.

Por meqë ne jemi duke lexuar fjalët e dijetarëve, atëherë duhet të dimë se çfarë kanë thënë ata në lidhje me këtë kapitull – Allahu i mëshiroftë! - dhe pastaj t'i ballafaqojmë qëndrimet e tyre me Kuranin dhe Sunetin Profetik. Nëse ato përkojnë me këto dy burime, atëherë ne i pranojmë qëndrimet e tyre dhe nëse nuk përkojnë, atëherë i lëmë ato dhe themi: “Allahu e faltë atë që e ka thënë.”

1 - Teksti original është me autor Ibn Kudamen dhe quhet “El Mukni”, të cilin e ka përmbledhur El Hixhau në librin e tij “Zad el-Mustekni'i fi Ikhtisar el Mukni”, të cilin shejh Muhamed bin Salih el Uthejmin e ka pajisur me komente dhe shpjegime në 15 vëllime. Ky libër trajton tema të jurisprudencës islame të medh'hebit hanbeli.

❧

Menstruacionet
(El Hajdu)
dhe Istihada

❧

Menstruacionet (el hajdu) në gjuhën arabe do të thotë: rrjedhje.

Në aspektin terminologjik fetar menstruacionet janë: Gjak natyral që del nga gruaja në disa ditë të njohura kur ajo mbërrin moshën e pubertetit.

Këtë gjak Allahu e ka krijuar për një urtësi, që është ushqim për fëmijën. Për këtë arsye në shumicën e rasteve gratë shtatzëna nuk kanë menstruacione, sepse ky gjak shkon tek fetusit nëpërmjet kërthizës dhe pastaj shpërndahet nëpër damarë në mënyrë që foshnja të ushqehet, pasi është e pamundur që ai të ushqehet apo të pijë në barkun e nënës së vet. Gjithashtu, nëse do të ushqehet, atëherë do të kishte nevojë për jashtëqitje. Kështu janë shprehur juristët myslimanë – Allahu i mëshiroftë.²

Menstruacionet janë gjak natyral, jo gjak kalimtar dhe as i rastësishëm. Përkundrazi, ai gjak është pjesë e natyrës femërore, siç iu drejtua i dërguari i Allahut a.s. Aishes r.a. duke i thënë: *“Kjo është një çështje që Allahu e ka bërë pjesë të domosdoshme për bijat e Ademit.”*³ D.m.th. e ka përcaktuar dhe e ka bërë pjesë të kaderit të Tij për to.

Në kundërshtim me menstruacionet, Istihada (gjaku jo menstrual) është gjak kalimtar dhe i rastësishëm, siç shprehet Profeti a.s. për të: *“Ai është gjak damari.”*⁴

Në këtë mënyrë, nëse njeriu e kupton që ky është një fenomen i caktuar dhe i shkruajtur për të, atëherë ai bëhet më i lehtë për t’u përballuar.

Gjakrat me të cilat përballen gruaja janë katër llojesh: menstruacionet, lehonja, Istihada dhe gjaku i prishur. Për të gjitha këto lloje do të sjellim përkufizimin e tyre dhe dispozitat përkatëse në vijim, dashtë Allahu.

Menstruacionet janë gjak natyral, por a kanë ato një kufi moshe përsa

2 - Ekspertët e mjekësisë shprehen se, trupi i gruas përgatitet për barrë çdo muaj dhe brendësia e mitrës fryhet duke bllokuar gjakun në pritje të vezores së pllenuar që të hyjë në të. Kur pllenimi dhe barra nuk ndodh, atëherë brendësia e mitrës e bllokuar nga gjaku shfryhet duke e nxjerrë atë nga vagina. Në këtë mënyrë ndodhin të ashtuquajturat menstruacione. Shih: “El Karar le Mekin”, dr. Memun Shefeka, f 41-45.

3- Buhariu 294; Muslimi 1211

4- Buhariu 328; Muslimi 333

i përket fillimit dhe mbarimit dhe një kufi përsa i përket ditëve?

Ajo që njihet në mesin e juristëve është se menstruacionet kanë një kufi, por qëndrimi më i saktë është se menstruacionet nuk kanë një kufi.

Fjala e autorit: “Nuk ka menstruacione para moshës nëntë vjeçare”

Kjo do të thotë se fetarisht nuk ka menstruacione para moshës nëntë vjeçare dhe nëse ato vijnë përpara kësaj moshe, atëherë nuk kemi të bëjmë me menstruacione, edhe nëse ato shfaqen në formën e një cikli normal të njohur dhe me karakteristikat e njohura të gjakut. Pavarësisht kësaj, ky gjak nuk është gjak i ciklit por gjak damari dhe dispozitat e menstruacioneve nuk përfshihen në këtë rast.

Fjala e autorit “para moshës nëntë vjeçare” d.m.th. para përfundimit të nëntë vjetëve. Për këtë arsye, nëse vajza që është nëntë vjeç dhe ka menstruacione, ato nuk konsiderohen të tilla vetëm pasi të ketë mbushur nëntë vjeç.

Përcillet nga imam Shafiu – Allahu e mëshiroftë! - se ai ka parë një gjyshe në moshën 21 vjeçare.”⁵

Kjo do të ishte e mundur vetëm nëse vajza do të kishte menstruacione në moshën nëntë vjeçare, pastaj do të lindte fëmijë në moshën dhjetë vjeçare. Pastaj vajza e saj do të kishte menstruacione në moshën nëntë vjeçare dhe do të lindte fëmijë në moshën dhjetë vjeçare. Kështu plotësohen njëzet vjet dhe një vit për barrën, kështu bëhen njëzet e një vjet.

5 - E përcjell Bejhakiu në “Sunen” 1/319. Et-Turkmaniu i shton një shënim duke thënë: “Në zinxhirin transmetues gjendet Ahmed bin Tahir bin Harmele.” Dar el Kutni thotë: “Ai është gënjeshtar”. Ibn Adiji thotë: “Ka rrëfyer gjëra prej gjithë të tija, e ky nga Shafiu, tregime dhe ngjarje të kota që mund të zgjatemi shumë po i përmendëm.” Edhe ky tregim është pjesë e këtyre rrëfimeve.

Fjala e autorit: "... dhe as pas moshës 50 vjeçare"

Kjo do të thotë se nuk ka menstruacione pas plotësimit të 50 viteve. Edhe nëse gruaja do të vazhdonte të kishte menstruacione sipas grafikut dhe fluksit të saj natyral pas moshës 50 vjeçare, ato nuk do të konsiderohen menstruacione.

P.sh: Një grua i mbush 50 vjeç në muajin Rabi'u Evel dhe në muajin pasardhës Rabi'u el-Thani i vijnë menstruacionet sipas ciklit të saj të zakonshëm. Sipas fjalës së autorit këto nuk konsiderohen menstruacione, sepse ato kanë ardhur pas moshës 50 vjeçare.

Ata nuk bëjnë dallim mes gruas joarabe dhe gruas arabe, as mes gruas së sëmure dhe gruas së shëndoshë, as mes gruas që i kanë filluar vonë menstruacionet dhe as asaj që i kanë filluar herët.

Argumenti i tyre për këtë qëndrim është se ardhja e menstruacioneve para dhe pas këtyre kufijve nuk është diçka e njohur zakonisht dhe tradita më e përhapur është që gruaja të mos ketë menstruacione para moshës nëntë vjeçare dhe as pas moshës 50 vjeçare.

Zakoni dhe shpeshtësia e rasteve ka ndikimin e vet në Legjislacionin Islam, prandaj Profeti a.s. i tha gruas që kishte Istihada: *"Qëndro aq sa të ka mbajtur cikli i menstruacioneve"*⁶ pra duke iu referuar periudhës që ajo e kishte zakon të qëndronte me menstruacione.

Shejhu i Islamit⁷, Ibn Mundhiri⁸ dhe të tjerë juristë kanë mbajtur këtë qëndrim.

Faktikisht nuk ka asnjë justifikim të saktë për këtë përcaktim, por kurdo që gruaja sheh gjakun e njohur të menstruacioneve tek gratë, atëherë ato janë menstruacione, pa marrë parasysh moshën e saj; qoftë e vogël apo e madhe. Argumentet për këtë qëndrim janë:

- 1- Kuptimi i përgjithshëm i fjalës së Allahut a.x.h.: "Të pyesin ty për menstruacionet. Thuaj: "Ato janë një papastërti."**

6 - Buhariu 306; Muslimi 334.

7 - Shiko "Mexhmu'u Feta'a" të Ibn Tejmijes 19/237, 240

8- Shiko "El Mugni" 1/389 dhe "El Mexhmu'u sherh el Muhedh-dheb" 2/373

(Bekare, 222). Fjala e Allahut a.x.h.: **“Thuaj: “Ato janë një papastërti”** do të thotë se kjo është një dispozitë që lidhet me një arsye, që është papastëria. Prandaj, kurdo që të gjendet ky gjak që është papastërti – dhe jo gjak damari- atëherë gjykohej se ai është gjak menstruacionesh.

Është e saktë se gruaja në shumicën e rasteve do të ketë menstruacione pasi të ketë plotësuar moshën nëntë vjeçare, por gratë janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Prandaj tradita ka të bëjë me llojin e grave dhe gjithashtu edhe me trashëgiminë e tyre. Disa gra qëndrojnë të pastra për gati katër muaj dhe u vijnë menstruacionet për një periudhë të plotë një mujore. Larg të metave është Allahu, tamam sikur gjaku të bllokohet dhe të vijë për të gjithë muajt së bashku.

Disa gra të tjera kanë menstruacione tri ditë në muaj ose katër ditë, ose pesë ose dhjetë ditë.

- 2- Thënia e Allahut a.x.h.: **“E ato nga gratë tuaja të cilat nuk presin më cikël mujor (menstruacione) nëse keni dyshim, koha e pritjes së tyre (pas divorcit) është tre muaj, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë patur menstruacione”** (Talak, 4) d.m.th. se koha e pritjes së tyre pas dhënies së divorcit është tre muaj dhe nuk ka thënë: para moshës nëntë vjeç dhe pas moshës 50 vjeç. Përkundrazi, Allahu a.x.h. thotë: Ato gra të cilat nuk presin më cikël dhe ato gra të cilat nuk kanë ende menstruacione. Pra, Allahu a.x.h. e ka lidhur këtë çështje me praninë e këtyre realiteteve të arsyetuara dhe mos-ekzistencën e tyre me mungesën e këtyre realiteteve. Kjo do të thotë se gruaja, e cila ka menstruacione në muajin e fundit të moshës 50 vjeçare dhe ka menstruacione në muajin e parë të moshës 51 vjeçare është një grua që pret menstruacione dhe nuk e ka humbur shpresën e ardhjes së tyre. Këto menstruacione janë të rregullta në numrin e tyre dhe në numrin e pastrimeve mes këtyre menstruacioneve pa asnjë kundërshtim, prandaj kush mund të thotë se kjo grua i ka humbur shpresat për menstruacione dhe nuk i pret ato?!

Allahu e ka lidhur fundin e menstruacioneve me humbjen e shpresës për ardhjen e tyre dhe në kohën kur gruaja mbush 50 vjeç, ajo nuk e ka humbur këtë shpresë nëse menstruacionet vazhdojnë si zakonisht. Për këtë arsye bëhet e qartë se, përcaktimi i fillimit të menstruacioneve

me moshën nëntë vjeçare dhe fundit te tyre me moshën 50 vjeçare nuk ka argument.

Qëndrimi i saktë është se vlerësimi bëhet sipas përshkrimit dhe karakteristikave. Menstruacionet janë përshkruar si papastërti dhe si rrjedhojë, në çdo moment që rrjedh gjaku që është papastërti, atëherë ai është menstruacion.

Nëse dikush thotë: A i përmend zakonisht Kurani vitet me numër?

Përgjigja është po. Allahu i Lartësuar thotë: **“E kur mbërriti moshën e pjekurisë dhe u bë dyzet vjeç.”** (Ahkaf, 15). Kjo do të thotë se nëse periudha e menstruacioneve do të kishte qenë e përcaktuar me vite, atëherë Allahu i Lartësuar kishte për ta bërë me dije, sepse përcaktimi me 50 vite është më i qartë se përcaktimi me mospritse dhe humbjen e shpresës.

Fjala e autorit: “As me shtatzëninë”

D.m.th. nuk ka menstruacione gjatë shtatzënisë. Argumentet për këtë janë Kurani dhe praktika. Argument kuranor është fjala e Allahut a.x.h.: **“E ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tre menstruacione”** (Bekare, 228) dhe **“E ato nga gratë tuaja të cilat nuk presin më cikël mujor (menstruacione) nëse keni dyshim, koha e pritjes së tyre (pas divorcit) është tre muaj, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacione”** (Talak, 4) d.m.th. koha e tyre e pritjes pas divorcit është tre muaj.

Po kështu edhe thënia e Allahut a.x.h.: **“Ndërkaq, për shtatzënat afati i pritjes së tyre (pas divorcit) është derisa të lindin.”** Kjo tregon se gruaja shtatzënë nuk ka menstruacione, sepse po të kishte, periudha e saj e pritjes do të ishte tre muaj, dhe kjo është periudha e pritjes për gruan e divorcuar.

Ndërsa praktika ka treguar se gruaja shtatzënë nuk ka cikël menstrual. Imam Ahmedi thotë: *“Gratë shtatzëna njihen nga ndërprerja e gjakut.”*

Disa dijetarë janë shprehur se gruaja shtatzënë mund të ketë menstruacione nëse i rrjedh gjaku i njohur i menstruacioneve të zakonshme. Argumenti i tyre për këtë qëndrim është ajo që përmendëm

se menstruacionet janë papastërti dhe kurdoherë që ato të ndodhin aktivizohen edhe dispozitat përkatëse.

Shfuqizimi i njohjes së menstruacioneve për gruan shtazënë nuk ka të bëjnë me faktin se nëse asaj i rrjedh gjak ai nuk konsiderohet gjak menstruacionesh, por për faktin se menstruacionet nuk mund të merren parasysh si periudhë pritjeje e gruas së divorcuar së bashku me shtatzëninë njëkohësisht, sepse shtatzënia i shfuqizon të gjitha kategoritë e pritjes pas divorcit apo vdekjes së burrit, prandaj ajo quhet “nëna e pritjeve” tek juristët myslimanë, Allahu i mëshiroftë.

Kësisoj, nëse një burrë vdes duke lënë gruan dhe ajo lind fëmijën vetëm tre orë pas vdekjes ose më pak se kaq, atëherë periudha e pritjes së gruas mbaron, ndërkohë që ajo grua që i vdes burri dhe ajo nuk është shtatzënë duhet të presë katër muaj e dhjetë ditë. Nëse gruaja shtatzënë e divorcuar ka menstruacione tri herë rresht në mënyrë të rregullt, pikërisht ashtu siç e ka ciklin e saj, atëherë koha e saj e pritjes nuk mbaron me mbarimin e tre menstruacioneve (por me lindjen).

Kjo është arsyeja përse divorcimi i gruas shtazënë është i lejuar, edhe nëse bën marrëdhënie me të në çast, sepse gruaja fillon kohën e pritjes menjëherë pas divorcit. Ajo nuk ka të pritje mbi bazën e menstruacioneve dhe mbi të bie divorci.

Qëndrimi më i saktë është se nëse gruaja shtatzënë sheh gjakun që i vjen në kohën e vet, në muajin e vet dhe në llojin e vet, atëherë ajo konsiderohet me menstruacione dhe duhet ta lërë namazin, agjërimin etj., por menstruacionet gjatë barrës ndryshojnë nga ato pa barrë për faktin se këto menstruacione nuk shërbejnë për periudhë pritje (divorci apo vdekje të burrit) për arsye se shtatzënia merret në konsideratë më shumë sesa menstruacionet përse i përket pritjeve (të divorcit apo vdekjes së burrit).

Kur menstruacionet i bashkangjiten barrës duhet të tregohemi të rezervuar, sepse nëse gruaja vazhdon të ketë menstruacione normale si zakonisht para barrës, atëherë ne gjykojmë se kemi të bëjme me menstruacione. Por nëse gjaku ndërpritet dhe pastaj i kthehet sërish teksa ajo është ende shtatzënë, atëherë ky gjak nuk është gjak menstruacionesh.

Fjala e autorit: “më e pakta e menstruacioneve është një ditë dhe një natë”

Kjo do të thotë se periudha më e shkurtër e menstruacioneve është një ditë dhe një natë, pra 24 orë. Ky është kufiri më i vogël përsa i përket periudhës më të shkurtër. Pra, nëse gruaja sheh se i kanë ardhur menstruacionet për 20 orë si zakonisht me erën, ngjyrën dhe trashësinë e tyre karakteristike, atëherë këto nuk janë menstruacione, sepse nëse janë më pak se një ditë dhe një natë nuk konsiderohen të tilla. Ky është medh’hebi.

Ata janë argumentuar duke thënë se nuk ekziston traditë tek gratë që të ketë menstruacione më të shkurtra se një ditë dhe një natë dhe përderisa nuk ka një traditë të tillë, atëherë periudha më e shkurtër e menstruacioneve le të jetë një ditë dhe një natë.

Ky nuk është argument, sepse ka gra të cilat nuk kanë fare menstruacione dhe disa të tjera kanë vetëm për disa orë derisa të pastrohen. Qëndrimi i saktë është se nuk ka një kufi për periudhën më të shkurtër të menstruacioneve.

Fjala e autorit: “Periudha më e gjatë është 15 ditë”

Kjo të thotë se kjo është periudha më e gjatë e menstruacioneve dhe ky është medh’hebi.

Ata janë argumentuar me zakonin, që do të thotë se zakonisht gratë nuk kanë menstruacione më shumë se 15 ditë, sepse nëse zgjasin më shumë se kaq mund të shkojnë deri në një muaj, ndërkohe që periudha e pastërtisë nuk mund të jetë më e shkurtër se periudha e menstruacioneve.

Nëse periudha e menstruacioneve është 16 ditë, atëherë periudha e pastërtisë është 14 ditë dhe nuk është e mundur që periudha e menstruacioneve të jetë më e gjatë se ajo e pastërtisë. Qëndrimi dijetarëve është se nëse gruas vazhdon t’i rrjedhë gjak në mënyrë të vazhdueshme, atëherë ai është gjak istihade (gjak damari). Nëse

menstruacionet vazhdojnë më shumë se gjysma e muajit, atëherë dispozita vlen për shumicën, pra sikur të ketë rrjedhur gjithë muajin dhe në këtë mënyrë çdo grua që ka rrjedhje gjaku për më shumë se 15 ditë merr dispozitën e Istihadës.

Nëse një grua pyet për gjakun që i rrjedh për 20 orë, a ta plotësojë namazin që ka lënë pa falur gjatë kësaj periudhe?!

Përgjigja është se ajo duhet ta plotësojë atë namaz, sepse ajo nuk ka patur menstruacione dhe se ajo faktikisht ka qenë e pastër gjatë kohës që nuk e ka falur namazin.

Por nëse një grua pyet për gjakun që i ka rrjedhur për më shumë se 15 ditë?

Përgjigja është se ti ke Istihada, prandaj mos rri pa falur namazin gjatë kësaj periudhe. Çdo gjak nuk është menstruacion nëse rrjedh më pak se një ditë dhe një natë, ose kur gruaja është shtatzënë, kjo nuk është as Istihada, por ka dispozitën e kësaj të fundit. Disa dijetarë e kanë quajtur “gjak i prishur”¹⁰.

Qëndrimi i saktë në lidhje me këtë çështje është se nuk ka kufi për periudhën më të gjatë të menstruacioneve. Disa gra kanë cikël të rregullt dhe të qëndrueshëm për shtatë ditë ose 16 ditë. Pyetja është: çfarë e bën gjakun para perëndimit të diellit në ditën e 15-të menstruacion dhe çfarë e bën gjakun një minutë pas perëndimit të diellit Istihada, edhe pse natyra, ngjyra dhe fluksi i tij janë të njëjtë?! Si mund të thuhet që pas kalimit të një minute ose dy minutash gjaku transformohet nga gjak menstruacioni në gjak Istihada pa asnjë argument? Nëse do kishte ndonjë argument për fjalën e tyre, ne do ta kishim pranuar.

Nëse gruaja ka një cikël të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm për 17 ditë – për shembull- do të themi që ky është menstruacion.

Por nëse gjaku vazhdon për të gjithë muajin ose ndërpritet për një periudhë të shkurtër një ose dy ditore, ose vjen me ndërprerje për disa orë dhe duke u pastruar për disa orë të tjera gjatë gjithë muajit, atëherë kjo është Istihada. Në këtë rast, ne e trajtojmë këtë situatë si Istihada, siç do ta sqarojmë në vijim, dashtë Allahu.

10- Shiko: “Mexhmu’u Fetaua”21/631, 632

Fjala e autorit: “Shumica e rasteve është gjashtë dhe shtatë ditë”

Kjo do të thotë se në shumicën e rasteve cikli i menstruacioneve tek gratë është gjashtë ose shtatë ditë.

Ky është një mendim i saktë i vërtetuar nga Suneti Profetik, ku përcillet se Profeti a.s. iu drejtua një gruaje me Istihada: *“Qëndro me menstruacione për gjashtë ose shtatë ditë, siç është në dijen e Allahut (siç të ka mësuar Allahu) dhe pastaj lahu tërësisht (merr gusël).”*¹¹

Gjithashtu ky është edhe realiteti, sepse në shumicën e rasteve menstruacionet e grave janë gjashtë ose shtatë ditore.

Fjala e autorit: “Periudha më e shkurtër mes dy menstruacioneve është 13 ditë”

Kjo do të thotë se nëse menstruacionet i vijnë përsëri pas dhjetë ditësh pastrimi, atëherë ato nuk konsiderohen menstruacione. Pra, nëse ajo i vëren menstruacionet përpara 13 ditëve, atëherë ato nuk janë menstruacione por kanë statusin e Istihadës.

Argumenti për këtë është ngjarja që përcillet nga Aliu r.a., kur një grua erdhi tek ai dhe i tha se periudha e saj e pritjes pas divorcit kishte mbaruar për një muaj. Aliu iu drejtua Shurejhut: “Gjyko ti për të.” Shurejhi tha: “Nëse na sjell një provë nga njerëzit e saj të afërt që njihen për fenë dhe edukatën e tyre, atëherë e pranojmë pretendimin e saj. Në të kundërt nuk e pranojmë.” Aliu tha: “Kalon - mirë (në gjuhën romake).”¹²

Kjo që bëri Shurejhi do të thotë se nëse gruaja ka kaluar vetëm një muaj pritje pas divorcit dhe pretendon se brenda muajit ka përfunduar periudha e pritjes (tre menstruacione rresht), kjo është e vështirë të ndodhë, prandaj ka nevojë të provohet.

Tre menstruacione brenda një muaji mund të imagjinohen vetëm kështu: gruaja ka menstruacione vetëm për një ditë dhe një natë dhe

11 - Ahmedi 6/439; Ebu Daudi 287; Tirmidhiu 128.

12 - Buhariu ka shënuar në kapitullin e tij: “Kapitulli – kur gruaja ka menstruacione tri herë në një muaj”.

qëndron e pastër për 13 ditë të tjera. Kështu kanë kaluar 14 ditë nga muaji. Më pas ajo kalon përsëri menstruacionet brenda një dite dhe një nate dhe me siguri që nga muaji kanë mbetur 14 ose 15 ditë të tjera. Pastaj ajo qëndron e pastër për 13 ditë dhe kështu kanë mbetur një ose dy ditë nga muaji. Pastaj ajo ka përsëri menstruacione për herë të tretë për një ditë dhe një natë. Në këtë mënyrë mbaron periudha e saj e pritjes pas divorcit, por kjo mund të ndodhë shumë rrallë.

Nëse gruaja pretendon se e ka përfunduar periudhën e pritjes pas divorcit duke i kaluar tre menstruacione sipas ciklit të saj të zakonshëm, atëherë pretendimi i saj pranohet. Gjithashtu, nëse pretendon se e ka përfunduar periudhën e pritjes pas divorcit pas tre menstruacioneve për një periudhë dy mujore e gjysmë, fjala e saj pranohet pa kërkuar prova, për arsye se Allahu e ka lënë periudhën e pritjes pas divorcit amanet në duart e grave duke thënë: **“Gratë e divorcuara duhet të përgjojnë vetë tre menstruacione. Atyre nuk u lejohet që të heshtin për atë që Allahu ka krijuar në mitrat e tyre nëse vërtet besojnë tek Allahu dhe tek Dita e Fundit.”** (Bekare, 228)

Nëse një grua e divorcuar pretendon se e ka përfunduar periudhën e pritjes për 28 ditë, atëherë pretendimi i saj nuk merret parasysh. Kjo do të thotë se kadiu (gjykatësi) do ta marrë në shqyrtim çështjen e saj dhe nuk e pranon atë pa prova të qarta.

Qëndrimi i saktë është që nuk ka kufi minimal për periudhën më të shkurtër të pastërtisë, siç e ka përzgjedhur Shejhu Islam¹³ dhe autori i “El Insaf”, që thotë se ky është qëndrim i saktë.¹⁴

Fjala e autorit: “Nuk ka kufi për periudhën më të gjatë.”

Kjo do të thotë se nuk ka kufi për periudhën më të gjatë të pastërtisë mes dy menstruacioneve, sepse ka gra të cilat nuk kanë fare menstruacione dhe ky është mendim i saktë.

13 - Shiko: “Mexhmu’u Fetaua” (19/227, 240); “El Ikhtijarat” f.28

14 - Shiko: “El Insaf” 2/396

Fjala e autorit: “Gruaja me menstruacione e shlyen agjërimin, por jo namazin.”

Nga kjo fjali përfitojmë katër dobi:

- 1- Gruaja me menstruacione nuk agjëron
- 2- Nuk falet
- 3- E shlyen agjërimin
- 4- Nuk e shlyen namazin.

Dobinë e parë dhe të dytë e nxorrëm nga çfarë nënkuptohet nga fjala e autorit, sepse nga fjala “shlyen” kuptojmë që ajo nuk e ka falur namazin.

Dobinë e tretë dhe të katërt e kuptuam nga vetë fjala e drejtpërdrejtë e autorit.

Argumenti për këtë është si vijon:

- 1- Kur gratë e pyetën të dërguarin e Allahut a.s. se cila është mangësia në fenë dhe mendjen tonë, o i dërguari i Allahut, ai u përgjigj: *“A nuk është gruaja ajo që kur i vijnë menstruacionet as nuk falet dhe as nuk agjëron?!” Ato thanë: “Po, o i dërguari i Allahut.” Tha: “Kjo është mangësia në fenë e saj.”¹⁵*
- 2- Kur e pyetën Aishen r.a. se si është e mundur që gruaja me menstruacione e shlyen agjërimin por nuk e shlyen namazin, ajo tha: *“Kjo na ndodhte edhe ne në kohën e të dërguarit të Allahut a.s. Ne ishim të urdhëruara që të shlyenim agjërimin dhe nuk ishim të urdhëruara që të shlyenim namazin.”¹⁶*
- 3- Dijetarët janë pajtuar për këtë qëndrim.

Nëse dikush thotë se, ky qëndron urtësia që gruaja me menstruacione të shlyejë agjërimin dhe të mos shlyejë namazin, themi se urtësia qëndron tek fjala e Profetit a.s. që u përmend më lart.

Dijetarët –Allahu i mëshiroftël!- kanë nxjerrë një urtësi dhe janë shprehur se agjërimi vjen vetëm një herë në vit, ndërsa namazi

15- Buhari 304; Muslimi 80.

16- Buhari 321; Muslimi 335.

përsëritet shpeshherë, prandaj shlyerja e agjërimit është më e lehtë për të dhe nëse nuk do ta shlyejë, i bie që ajo të mos agjërojë. Ndërsa namazi është një detyrë që përsëritet shpesh dhe nëse do ta ngarkonim gruan që ta shlyente atë do të ishte mjaft e vështirë për të.

Gjithashtu, ajo nuk do ta humbasë namazin për shkak se ai përsëritet, prandaj atë çfarë e humbi në fillim të muajit do ta kapë përsëri në fund të tij.

Fjala e autorit: “Ato të dyja nuk janë të sakta për gruan me menstruacione”

Kjo do të thotë se as agjërimi dhe as namazi nuk janë të vlefshme për gruan me menstruacione. Nëse gruaja kujton një detyrim që iu ka shpëtuar para menstruacioneve dhe e shlyen atë pasi i kanë ardhur menstruacionet, ajo nuk e ka shlyer detyrimin. Dhashë një shembull për një detyrim të shkuar, sepse ai është detyrim për gruan, ndërsa detyrimet e tanishme nuk janë të tilla për të.

Po kështu nëse thotë: “Kam dëshirë të agjëroj bashkë me njerëzit dhe do të tregoj kujdes që të mos rrjedhë gjaku” dhe pastaj agjëron. Agjërimi i saj në këtë rast nuk është i saktë duke u nisur nga hadithi i lartëpërmendur.

Fjala e autorit: “Përkundrazi janë të ndaluara.”

Kjo do të thotë se namazi dhe agjërimi janë të ndaluara për të.

Arsyetimi për këtë qëndrim është se, çdo gjë që nuk është e saktë të kryhet është haram.

Profeti a.s. thotë: “Çdo kusht që vendoset (në një marrëveshje) dhe nuk gjendet në librin e Allahut është i pavlerë, edhe nëse janë njëqind kushte.”¹⁷

17 - Buhariu 2561, 2562; Muslimi 1504

Fjala e autorit: “...dhe ndalohet që të bëhet marrëdhënie me të në organin gjenital.”

Kjo do të thotë se ndalohet marrëdhënia seksuale me gruan me menstruacione në organin e saj gjenital.

Argumentet për këtë janë:

- 1- Thënia e Allahut të Lartësuar: **“Të pyesin ty (o Muhamed) për menstruacionet. Thuaji: “Ato janë papastërti, prandaj distancojini gratë në menstruacione dhe mos iu afroni atyre derisa të pastrohen.”** (Bekare; 222)

Menstruacionet këtu nënkuptojnë vendin dhe kohën e tyre, pra mos iu afroni grave as në kohën e menstruacioneve dhe as në vendin e tyre, që është organi gjenital i gruas. Për aq kohë sa ajo është menstruacione marrëdhëniet me të në organet gjenitale janë të ndaluara.

- 2- Thënia e Profetit a.s. kur zbriti ajeti i mësipërm: *“Bëni gjithçka përveç marrëdhënieve”*¹⁸, pra përveç kontaktit me organet gjenitale.

Fjala e autorit: “Dhe nëse e bën”, pra nëse bën marrëdhënie me gruan në organet gjenitale.

Fjala e autorit: “Atëherë mbi të rëndon një dinar ose gjysëm dinari shpagim” pra ai duhet të shpaguejë shkeljen me një dinar ose gjysmë dinari.

Dinari është një monedhë ari dhe pesha e dinarit islam është një mithkalë arë. Një mithkalë arë është e barabartë me dy gramë e një çerek. Një rijal saudit është i barabartë me dy mithkalë pa pak, kështu që gjysma e paundit saudit mjafton dhe mund të pyetet në treg për vlerën e tij.

P.sh. nëse paundi saudit është i barabartë me njëqind rijalë, atëherë

18 - Muslimi 302.

detyrimi është 50 rijalë ose 25 rijalë afërsisht që i jepen fukarait.

Fjala e autorit “ose gjysma” do të thotë se është me zgjedhje. Pra, ai e ka për detyrë të japë sadeka një dinar ose gjysmë dinari, sepse “ose” përdoret për zgjedhje.

Argumenti për këtë qëndrim është hadithi i përcjellë nga Ibn Abasi tek të gjitha “Sunenet” – Allahu qoftë i kënaqur prej tij!- se i dërguari i Allahut a.s. ka thënë për burrin që kryen marrëdhënie me gruan e vet me menstruacione: *“Jep sadaka një dinar ose gjysmë dinari.”*¹⁹

Dijetarët kanë patur mospajtime në lidhje me saktësinë e këtij hadithi. Një grup dijetarësh e kanë vlerësuar të saktë, saqë imam Ahmedi thoshte: “Nuk ka hadith më të mirë”, ndërsa Ebu Daudi thoshte kur e përcolli: “Ky është transmetimi i saktë.”

Ndërsa disa dijetarë të tjerë e kanë vlerësuar si hadith të dobët, saqë imam Shafiu thoshte: “Nëse do të qëndronte do ta rrëfeja.”

Për këtë arsye domosdoshmëria e shpagimit janë pjesë e medh’hebit, ndërsa tre imamët e tjerë mendojnë se ai është gjynahqar dhe nuk ka shpagim.

Por qëndrimi i drejtë është se hadithi është i saktë, për arsye se të gjithë përcjellësit e tij janë njerëz të besueshëm dhe nëse është i tillë, atëherë nuk asgjë nëse Ahmedi veçohet nga të tjerët me qëndrimin e tij.

Pra, qëndrim i saktë është se shpagimi është i detyrueshëm. Të paktën themi që për të qënë të sigurtë ai është i detyrueshëm.

Po gruaja e ka shpagim për të? Autori ka heshtur në lidhje me këtë pikë.

Dikush është shprehur se ajo nuk ka asnjë detyrim për shpagim²⁰, sepse i dërguari i Allahut a.s. ka thënë: *“Jep sadaka një dinar ose gjysmë dinari”* dhe ka heshtur për gruan. Dikush tjetër është shprehur se ajo e ka për detyrim shpagimi, ashtu si dhe burri nëse i bindet atij. Ata arsyetohen me faktin se shkelja është një; ashtu siç nuk duhet që të afrohet ai, gjithashtu nuk duhet që ajo t’ia japi atij këtë mundësi. Nëse ia jep këtë mundësi, atëherë edhe ajo e ka pranuar këtë veprim të ndaluar, prandaj

19- Ahmedi 1/230, 237; Ebu Daudi 264; Nesaiu 288, Trimidhiu 136; Ibn Maxheh 640.

20 - Shih: “El Insaf” 2/380

e ka për detyrim që të japë shpagim.

Gjithashtu, ajo e ka për detyrim duke bërë analogji me të gjitha rastet e ndaluara të marrëdhënieve në organet gjenitale. P.sh. nëse ajo bën imoralitet me zgjedhjen e saj, ajo ndëshkohet. Gjithashtu nëse burri i saj bën marrëdhënie me të gjatë kohës së Haxhit përpara se ta heqë ihramin e parë, haxhi i saj është i prishur. Nëse i bindet që të prishë agjërimin, gjithashtu agjërimi saj është i prishur dhe duhet që ajo ta shpaguej atë.

Fakti që Profeti a.s. ka heshtur për gruan, kjo nuk do të thotë se shpagimi ka të bëjë vetëm me burrin, sepse fjala e drejtuar për burrat përfshin edhe gratë dhe e kundërta, përveç rasteve që përjashtohen me argument.

Shpagimi është i detyrueshëm vetëm me tri kushte:

- 1- Të ketë dijeni për veprimin
- 2- Të jetë i vetëdijshëm për veprimin
- 3- Ta bëjë me zgjedhjen e vet.

Pra, nëse është i painformuar për ndalimin e veprës apo i painformuar rreth menstruacioneve, ose ka harruar apo gruaja është detyruar me forcë që ta bëjë, ose nëse menstruacionet vijnë gjatë marrëdhënieve, atëherë nuk ka shpagim dhe as gjynah.

Fjala e autorit: “Kënaqet me gruan poshtë organeve.”

Kjo do të thotë se burri mund të kënaqet me gruan tij në vende të tjera përveç organeve gjenitale.

Kështu atij i lejohet që të kënaqet sipër izarit (copë që mbulon trupin nga kërthiza tek këmbët) ose poshtë tij. Gruaja e tij duhet të vendosë izar, sepse i dërguari i Allahut a.s. e urdhëronte Aishen r.a. që të vendoste izar para se të kishte kontakt me të teksa ishte me menstruacione.²¹ Urdhri i Profetit a.s. që Aishja të vishte izar kishte të bënte me faktin që ai të mos shihte shenja të padëshirueshme të gjakut. Kështu, nëse burri kënaqet me gruan e tij midis dy kofshëve për shembull, atëherë

21- Buhariu 300; Muslimi 293

nuk ka asgjë të keqe.

Nëse dikush thotë: Cila është përgjigja jote në lidhje me fjalën e Profetit a.s., kur u pyet se me çfarë i lejohet burrit të kënaqet me gruan e vet teksa është me menstruacione? Ai tha: *“Mundesh sipër izarit”*,²² gjë e cila tregon se të kënaqurit bëhet mbi izar.

Përgjigja është si vijon:

- 1- Ky veprim bëhet për të qenë më larg gjynahut dhe më larg të ndaluarës
- 2- Gjërat kuptohen sipas ndryshimit të situatave. Thënia e Profetit a.s.: *“Bëni gjithçka përveç marrëdhënieve”* bën fjalë për atë njeri që e përmban veten, ndërsa thënia e tij a.s.: *“Mundesh sipër izarit”* është për atë njeri që nuk e përmban veten për shkak të fesë së dobët apo për shkak të epshit të fortë.

Nëse burri kënaqet me gruan e vet përveç organeve gjenitale, nuk e ka për detyrë të marrë gusël vetëm nëse kalon në derdhje, ndërsa nëse gruaja kalon në derdhje gjatë menstruacioneve e ka guslin një vepër të pëlqyeshme, në mënyrë që të largojë gjurmët e xhynubllëkut, pa marrë parasysh nëse ajo bëhet xhynyb pas menstruacioneve si në rastin e shikimit të ëndrrave apo pas menstruacioneve. Kështu thonë dijetarët²³ dhe ajo mund të përfitojë prej këtij gusli për të bërë vepra të pëlqyera, si: leximi i pjesëve të Kuranit që ajo ka nevojë, siç janë virdet ose të mësojë apo t’u mësojë të tjerëve Kuran.

Fjala e autorit: “Nëse menstruacionet ndërpriten dhe ajo nuk ka marrë gusël, atëherë nuk lejohet gjë tjetër përveç agjërimit dhe divorcit”

Kjo do të thotë se, nëse gruas i ndërpritet gjaku dhe nuk ka marr gusël, çdo gjë mbetet në statusin e haramit përveç agjërimit dhe divorcit.

Përsa i përket agjërimit kanë thënë se, nëse gruaja pastrohet ajo është në statusin e atij që është bërë xhynub, prandaj asaj i lejohet që të

22 - Ebu Daudi 212; Ibn Maxheh në librin “Falja e namazit” 1375; Bejhakui 1/312; Dar el Kutni 216 etj.

23- Shiko: “El Insaf” 2/104, 105

agjërojë me argument nga Kurani dhe Suneti.

Argumenti nga Kurani është thënia e Allahut a.x.h.: **“Tani hyni në marrëdhënie me to dhe kërkoni atë që Allahu ka përcaktuar për ju. Hani e pini derisa të dallohet qartë peri i bardhë i agimit nga peri i zi (errësira e natës). Pastaj vazhdojeni agjërimin deri në mbrëmje.”** (Bekare, 187) Pra, nëse lejohen marrëdhëniet deri në ardhjen e agimit, kjo domosdoshmërisht kërkon që të gdhijë xhynyb.

Ndërsa përsa i përket Sunetit, përcillet nga Aishja r.a. se i dërguari i Allahut a.s. në Ramazan gdhinte xhynyb nga marrëdhëniet e jo nga ëndrrat, dhe pastaj agjëronte.²⁴

Autori nuk ka përmendur më lart ndalimin e divorcit, por nga fjala e tij këtu: “Nuk lejohet gjë tjetër veç agjërimit dhe divorcit”, kuptohet që ai është i ndaluar gjatë menstruacioneve.

Argumenti për lejimin e divorcit pas ndalimit të gjakut është thënia e Profetit a.s.: *“Urdhëroje që ta ktheje (gruan e divorcuar), pastaj le ta divorcojë kur të jetë e pastër ose shtatzënë”*²⁵ dhe gruaja konsiderohet e pastër pas ndalimit të gjakut.

Por nëse dikush pyet: A lejohen marrëdhëniet seksuale?

Përgjigja është jo. Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: **“Dhe mos iu afroni atyre (grave tuaja) derisa të pastrohen dhe nëse pastrohen, shkojuni atyre andej nga ju ka urdhëruar Allahu.”** (Bekare, 222)

Nëse dikush thotë: Nëse gruaja është xhynyb, atëherë lejohet që të kryhen marrëdhënie me të përpara guslit? Po kështu edhe në këtë rast, pas ndalimit të menstruacioneve pa marrë edhe gusël?

Përgjigja është se, kjo është një analogji që nuk mund të përballet me tekstin e qartë fetar, prandaj nuk merret në konsideratë.

Nëse dikush pyet: Thënia e Allahut: **“...nëse pastrohen”** do të thotë pastrojë gjurmët e gjakut?

Përgjigja është se kështu janë shprehur disa dijetarë, siç është Ibn

24 - Buhariu 193, 1932; Muslimi 1109.

25 - Buhariu 4908; Muslimi 1471

Hamzi, Allahu e mëshiroftë!²⁶. Por ne themi se qëllimi është pastrimi nga papastërtia dhe kjo arrihet përmes guslit. Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: **“E nëse jeni xhynyb, atëherë pastrohuni”** (Maide, 6) dhe: **“Por Ai dëshiron që t’ju pastrojë...”**

Fjala e autorit: “Fillestarja qëndron në periudhën më të shkurtër dhe pastaj merr gusël dhe falet.”

Fillimisht autori – Allahu e mëshiroftë! - fillon me sqarimin e llojeve të gjakut që konsiderohen apo jo menstruacion.

Fillestarja është ajo femër e cila i përjeton menstruacionet për herë të parë, qoftë vajzë në moshë të vogël apo grua në moshë të madhe, e cila nuk ka patur më parë menstruacione dhe pastaj i kanë ardhur.

Fjala e autorit “qëndron” ka kuptimin që nuk falet dhe nuk agjëron, apo gjithçka tjetër që nuk bëhet gjatë periudhës së menstruacioneve.

Fjala e autorit “më të shkurtër” do të thotë periudha më e shkurtër e menstruacioneve që është një ditë dhe një natë.

Fjala e autorit: “pastaj merr gusël dhe falet” do të thotë se pasi të kenë kaluar 24 orë, ajo merr gusël dhe fal namazin, edhe nëse gjaku nuk ka ndaluar.

Arsyetimi i tyre për vendosjen e periudhës më të shkurtër është se, kjo është periudha më e sigurtë e menstruacioneve dhe nëse menstruacionet vazhdojnë më gjatë se kaq, kjo është e dyshimtë. Prandaj ajo duhet të qëndrojë në këtë gjendje vetëm aq sa është periudha më e shkurtër e menstruacioneve.

Fjala e autorit “falet” do të thotë namazet farz, por fjala e tij në dukje përfshin edhe namazet vullnetare. A është kjo ajo që nënkupton autori?

Ajo që kuptoj unë se nëse është ky kuptimi i fjalës së tij, ky është një qëndrim i dobët, sepse namazi i saj në këtë moment kryhet vetëm për siguri, prandaj ajo duhet të kufizohet vetëm tek namazet e detyrueshme,

26- Shiko: “El Muhal-la”, 2/172

sepse në origjinë kemi të bëjmë me gjak menstruacionesh dhe namazet vullnetare nuk mund të jenë për siguri, për arsye se njeriu nuk ka gjynah në rast se nuk i fal ato. Prandaj nuk ka pse të sigurohet për to.

Për këtë arsye fjala e autorit “nuk falet” duhet të nënkuptojë namazet e detyrueshme, sepse për to mund të ngarkohet me gjynah nëse nuk i fal, në ndryshim nga namazet vullnetare.

Ajo gjithashtu agjëron ditët e agjëritimit të detyrueshëm. Kësisoj, nëse e fillon Ramazanin me menstruacione, atëherë ajo qëndron ashtu për një ditë dhe një natë dhe pastaj agjëron për të qenë e sigurtë.

Fjala e autorit: “Nëse gjaku ndërpritet kur plotësohet periudha më e gjatë e menstruacioneve ose më pak se aq, atëherë ajo merr gusël në kohën kur gjaku ndërpritet.”

Pra, nëse gjaku vazhdon të rrjedhë dhe pastaj ndërpritet në periudhën me të gjatë, pra 15 ditore ose më pak se aq, p.sh. dhjetë ditore, vetëm nëse vazhdon më pak se një ditë dhe një natë.

Fillimisht do të sqarojmë qëndrimin e medh’hebit dhe pastaj do të kthehemi tek qëndrimi më i saktë. Nëse japim një shembull: Një grua qëndron me menstruacione për një ditë dhe një natë dhe pastaj merr gusël dhe vazhdon të falet dhe të agjërojë. Por gjaku i saj vazhdon dhe ndërpritet vetëm pasi ka mbushur 15 ditë ose më pak, po themi 10 ditë. Atëherë ajo do të marrë gusël edhe një herë tjetër. Për këtë arsye autori thotë: ***“...ajo merr gusël në kohën kur gjaku ndërpritet”***. Kjo është e detyrueshme të kryhet, sepse ka shumë mundësi që gjaku i cili ka vazhduar përtej një dite dhe një nate mund të jetë gjak menstruacionesh dhe për këtë arsye ajo duhet të marrë gusël për siguri. Në këtë mënyrë ajo merr gusël dy herë; një herë kur plotëson një ditë dhe një natë dhe herën e dytë kur ndërpritet gjaku.

Le të supozojmë se në muajin Muharrem ajo veproi kështu dhe pastaj vjen muaji tjetër Seferi dhe ajo vepron siç veproi në muajin Muharrem. Kur vjen muaji tjetër, që i bie të jetë muaji Rebiu Evel, ajo vepron siç veproi në muajin Muharrem, pra qëndron me menstruacione një ditë dhe një natë dhe pastaj falet dhe agjëron. Kur gjaku i ndërpritet pas

dhjetë ditëve, ajo vepron siç e përmendëm në shembull, duke marrë gusël për herë të dytë dhe fal namazin. Në këtë rast asaj i përsëritet për të tretën herë.

Fjala e autorit: “Nëse përsëritet për tre menstruacione radhazi” siç e përmendëm në shembullin e lartëpërmendur, atëherë cikli i saj do të jetë dhjetë ditë. Por, si do të veprojë ajo për ditët midis një dite dhe një nate deri në dhjetë ditë, sepse ajo në këto ditë falte namazin dhe agjëronte, por më vonë u bë e qartë se ato ishin ditë me menstruacione?

Themi se përse i përket namazeve, edhe pse nuk janë të vlefshme për të në kohë menstruacionesh, ajo nuk do t’i shlyejë ato kaza, sepse gruaja me menstruacione nuk e ka për detyrë faljen e namazit dhe nuk ka gjynah nëse nuk e fal atë. Ajo më parë ka vepruar kështu për t’iu bindur Allahut dhe për të qenë e sigurtë.

Nga ana tjetër ajo duhet të shlyejë agjërimin, për arsye se tashmë është bërë e qartë se ajo ka qenë në ditën e veta me menstruacione dhe agjërimi nuk është i vlefshëm në ditët e ciklit. Por, nëse supozojmë që kjo ndodh në muajin e Ramazanit?

Fjala e autorit: “Ajo shlyen atë që e ka për detyrim”

Kjo do të thotë se ajo shlyen çdo adhurim që është i obliguar për gruan me menstruacione, por që nuk është i vlefshëm në kohën e ciklit menstrual, siç e përmendëm në shembullin e mësipërm. Ky është rregull.

Nëse ndodh që ky cikël menstruacionesh nuk përsëritet tri herë, pra nëse në muajin e parë është 10 ditë, në muajin e dytë 8 ditë dhe në muajin e tretë 6 ditë, atëherë vetëm gjashtë ditor është cikli që merret parasysh. Nëse në muajin e katërt përsëritet cikli tetë ditor tri herë, atëherë cikli tetë ditor merret në konsideratë. Nëse në muajin e pestë përsëritet tri herë cikli dhjetë ditor, atëherë cikli i saj i menstruacioneve është dhjetë ditë. Pra, ai cikël që përsëritet tri herë, është cikli që merret në konsideratë.

Fjala e autorit: “Nëse cikli e tejkalon periudhën më të gjatë, atëherë është Istihada.”

“Tejkalon” do të thotë kalon kufirin. “Periudhën më të gjatë” do të thotë 15 ditë. “Istihada” do të thotë se është Istihada për fillestaren apo për jofillestaren.

Një shembull për fillestaren: Një gruaje i vijnë menstruacionet për herë të parë dhe i vazhdojnë derisa i kalojnë 15 ditë. Kja grua është fillestare, sepse nuk ka patur më parë cikël menstrual. Nëse gjaku i saj do të ishte Istihada, atëherë ka vetëm dy mundësi:

- 1- Nëse arrin ta dallojë dhe kjo është shenjë e veçantë.
- 2- Shihet periudha e zakonshme që kalojnë gratë e afërta me të. Ky është rasti i përgjithshëm, ndërsa rasti i veçantë është më parësor që të merret në konsideratë se rasti i përgjithshëm.

Istihada është rrjedhje e gjakut nga një damar në pjesën më të poshtme të mitrës, që quhet El Adhil. P.sh. nëse gruas i ndodh një lëndim në damar dhe gjaku fillon të dalë në vazhdimësi, ky nuk është një gjak natyral, por është një sëmundje për shkak të dëmtimit të një damari në pjesën më të poshtme të mitrës.

Ndërsa menstruacionet janë rrjedhje e gjakut që vjen nga brendësia e mitrës dhe quhet El Adhir.

Më tej autori sqaron dallimin midis tyre dhe thotë: “Nëse një pjesë e gjakut të saj është i kuq dhe një pjesë tjetër është i zi” kjo është një nga shenjat dalluese. Në këtë rast gruas i thuhet: “Shiko dallimin.”

Temjizi, ose shenja dalluese, është të sigruarit derisa të njihet me siguri nëse kemi të bëjmë me gjak menstruacionesh apo gjak Istihadeje.

Autori ka përmendur vetëm një shenjë dalluese që është ngjyra, por temjizi ka katër shenja dalluese:

- 1- Ngjyra; ku ngjyra e gjakut të menstruacioneve është e zezë, ndërsa ngjyra e gjakut të Istihadës është e kuqe.
- 2- Trashësia; ku gjaku i menstruacioneve është i ashpër dhe trashë,

ndërsa ai i Istihadës i hollë.

- 3- Aroma; ku aroma e gjakut të menstruacioneve është e keqe, ndërsa gjaku i Istihadës nuk është i tillë, sepse është gjak që vjen nga një damar i zakonshëm.
- 4- Mpiksja; ku gjaku i menstruacioneve nuk mpikset kur pastrohet, sepse ai mpikset në mitër dhe pastaj shpërthen dhe rrjedh. Ai nuk mpikset më për herë të dytë. Ndërsa gjaku i Istihadës mpikset, sepse është gjak damari. Kështu e përcaktojnë disa njerëz bashkëkohorë në fushën e mjekësisë. Për këtë fakt ka folur edhe i dërguari i Allahut a.s. që thotë: *“Ai është gjak damari”* dhe siç dihet gjaku i damarit mpikset.

Fjala e autorit: “Nëse nuk tejkalon periudhën më të gjatë”
do të thotë nëse gjaku i zi nuk e tejkalon periudhën më të gjatë të menstruacioneve, sepse nëse e tejkalon këtë periudhë atëherë nuk mund të konsiderohet gjak menstruacionesh.

Pra, nëse një grua ka patur menstruacione për 25 ditë, ku 20 ditë kanë qenë me gjak të zi dhe pesë ditë me gjak të kuq, atëherë gjaku i zi nuk mund të konsiderohet gjak menstruacionesh, sepse e ka tejkaluar periudhën më të gjatë të mundshme të menstruacioneve.

Fjala e autorit: “...dhe nëse nuk është më pak se periudha më e shkurtër, atëherë ato janë menstruacionet e saj që do t'i mbajë në muajin e dytë, ndërsa i kuqi është Istihada.”

Pra, nëse gjaku i zi nuk vjen më pak se periudha më e shkurtër e menstruacioneve që është një ditë dhe një natë. Nëse një fillestare thotë se në ditën e parë ka patur gjak të zi dhe pastaj është bërë i kuq për 20 ditët e tjera, atëherë ajo nuk i referohet asnjë shenjë dalluese, sepse ky gjak nuk vlen që të jetë gjak menstruacionesh për shkak se ka zgjatur më pak se një ditë dhe një natë.

Nëse thotë se ajo ka patur gjak të zi për gjashtë ditë rresht, atëherë ai është gjak menstruacionesh, sepse është më shumë se periudha më e shkurtër, ndërsa pjesa tjetër e gjakut të kuq është gjak Istihada.

Fjala e autorit: “Nëse gjaku i saj nuk është i dallueshëm, atëherë ajo do të marrë në konsideratë periudhën tradicionale të menstruacioneve”, pra fillestarja.

Periudha normale dhe tradicionale e menstruacioneve është gjashtë ose shtatë ditë. Argumenti për këtë është thënia e Profetit a.s.: *“Qëndro me menstruacione për gjashtë ose shtatë ditë, siç është në dijen e Allahut (siç të ka mësuar Allahu)...”*²⁷

Pra, nëse është e vështirë që diçka të përcaktohet në mënyrë specifike, atëherë duhet t'i referohemi llojit në tërësi. Përderisa kjo grua e ka të vështirë të përcaktojë periudhën e ciklit të saj, atëherë duhet t'i referohemi llojit të saj, pra grave në përgjithësi.

Qëndrimi më i saktë është që ajo duhet t'i referohet grave të afërta me të, siç është motra, nëna etj. dhe jo periudhës së menstruacioneve të grave në tërësi, sepse ngjashmëria e gruas me njerëzit e saj të afërt është më e madhe se ngjashmëria e saj me shumicën e grave.

Fjala e autorit: “të çdo muaji”, sepse shumica e grave kanë menstruacione një herë në çdo muaj.

Argumenti për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: “Gratë e divorcuara duhet të përgjojnë vetë tre menstruacione” (Bekare, 228) dhe **“E ato nga gratë tuaja të cilat nuk presin më cikël mujor (menstruacione) nëse keni dyshim, koha e pritjes së tyre (pas divorcit) është tre muaj, e ashtu edhe ato që ende nuk kanë pasur menstruacion”** (Talak, 4)

Allahu ka vendosur një cikël për çdo muaj dhe kjo përbën shumicën e rasteve.

Muaji menstrual fillon nga dita e parë e rrjedhjes së gjakut, pra nëse dita e parë e menstruacioneve është dita e 15-të e muajit, atëherë numërimi fillon nga kjo ditë dhe nëse themi “shtatë ditë”, atëherë menstruacionet vazhdojnë deri në ditën e 22-të të muajit dhe nëse

27- Ahmedi 6/439; Ebu Daudi 287; Tirmidhiu 128.

themi “gjashtë ditë”, atëherë menstruacionet vazhdojnë deri në ditën e 21-të muajit.

Nëse gruaja harron dhe nuk është e sigurtë nëse menstruacionet i kanë ardhur në ditën e parë të muajit, në ditën e dhjetë apo në ditën e njëzetë, atëherë e vendos në fillim të muajit për të qënë më e sigurtë.

Dije se këto dispozita nuk janë vetëm për namazin, por edhe edhe për dispozitat që kanë lidhje me menstruacionet dhe lidhen me këto ditë nëse gjykojmë se janë ditë menstruacioni dhe nëse themi që janë ditë të pastra, atëherë ato do të kenë lidhje me dispozitat që kanë të bëjnë me ditët pa menstruacione.

Në mënyrë të përmbledhur mund të themi se, fillestarja që ka Istihada do të vërë në punë shenjat dalluese dhe nëse nuk arrin dot të bëjë dallimin, atëherë do të bazohet mbi rastet më të shpeshta tek gratë dhe do të qëndrojë me menstruacione për gati gjashtë ose shtatë ditë duke filluar nga momenti që sheh gjakun. Nëse harron se kur e ka parë gjakun, atëherë e fillon numërimin nga fillimi i muajit hënor, por siç e thamë edhe më lart qëndrimi më i saktë është që ajo të bazohet mbi rastet më të shpeshta të grave.

Fjala e autorit: “Gruaja jo fillestare me Istihada, edhe nëse arrin të dallojë shenjat do të qëndrojë me menstruacione aq ditë sa janë zakonet e saja.”

Gruaja jo fillestare është ajo që ka patur një cikël të rregullt menstrual përpara Istihadës dhe pastaj ka patur Istihada.

Për shembull, nëse një gua ka patur menstruacione të rregullta dhe të plota për një periudhë gjashtë ditore në fillim të çdo muaji dhe pastaj e zë sëmundja e Istihadës duke patur rrjedhje gjaku për pjesën më të madhe të muajit, atëherë ajo është një grua me Istihada të zakonshme dhe i themi asaj: Sa herë që të vijë muaji, qëndro me cikël menstrual nga dita e parë deri në ditën e gjashtë.

Fjala e autorit “...edhe nëse arrin të dallojë shenjat” do të thotë se ajo do të qëndrojë me ciklin e saj si zakonisht, edhe nëse gjaku i saj është dallueshëm në rast menstruacionesh apo jo.

Për shembull: Një grua ka ciklin e zakonshëm nga fillimi i muajit deri në ditën e dhjetë, por në ditën e njëmbëdhjetë ajo sheh gjak të zi për gjashtë ditë rresht dhe në pjesën e mbetur të ditëve sheh gjak të kuq. Kjo është një grua që ka një cikël të rregullt dhe arrin të dallojë shenjat. Qëndrimi më i njohur në medh’heb është se ajo do të marrë për bazë vetëm ditët e saja të zakonshme të ciklit.

Ata janë argumentuar me thënien e Umu Habibe bintu Xhahshit që ka thënë: *“Qëndro për aq kohë sa të kapin menstruacionet”*²⁸, ku i dërguari i Allahut a.s. iu referuar ditëve të saja të zakonshme të ciklit. Është e mundur gjithashtu që ajo të ketë patur aftësinë për të kuptuar shenjat dalluese, por i dërguari i Allahut a.s. nuk pyeti me detaje dhe kjo do të thotë se edhe nëse ajo është në gjendje të bëjë dallimin, ajo duhet t’i përmbahet në çdo rast vetëm ditëve të saja të zakonshme të ciklit.

Imam Shafiu²⁹ dhe në një transmetim nga Ahmed³⁰ janë të mendimit se ajo duhet t’i referohet shenjave dalluese, duke u argumentuar me sa vijon:

- 1- Thënia e Profetit a.s.: *“Gjaku i ʿzi i menstruacioneve njihet.”*³¹ Ai thotë se bëhet fjalë për gruan me Istihada. Gratë të cilët kanë patur Istihada në kohën e Profetit a.s. kanë qënë afërsisht 17 gra³² dhe nuk është e pamundur që cikli të kalojë nga fillimi i muajit në mes të tij për shkak të sëmundjes së Istihadës që i ndodh asaj.
- 2- Dallimi është një shenjë e qartë dhe për këtë duhet që t’i referohemi.

Qëndrimi më i saktë është se gruaja duhet t’i referohet ciklit të saj të zakonshëm, sepse hadithi që flet për dallimin ka patur mospajtime në lidhje me saktësinë e tij.

Nga ana tjetër është më e lehtë dhe më e saktë për gruan që të

28 - Muslimi 334.

29 - Shiko: “El Mexhmu sherhil muhedh-dheb” 2/431

30- Shiko: “El Insaf” 2/412

31 - Ebu Daudi 286; Nesaiu 1/123; Ibn Hibani 1348 etj.

32 - Shiko: “Fet’hulbari” 1/412; “Feraid el feuaid” e autorit f.191

mbështetet tek cikli i saj i zakonshëm, sepse gjaku i zi ose me aromë të keqe apo i trashë, ndoshta e humbet normalitetin, ndryshon dhe kalon në fund të muajit apo në fillim të tij, ose ndëpritet dhe bëhet një ditë i zi dhe një ditë i kuq.

Fjala e autorit: “Nëse e harron vepron mbi bazën e dallimit të vlefshëm”, pra nëse harron ciklin e saj.

Dallimi i vlefshëm do të thotë që vlen që të jetë cikël menstrual, në mënyrë të atillë që të mos jetë më pak se periudha më e shkurtër dhe as më i gjatë se periudha më e gjatë.

Për shembull, nëse një grua e harron ciklin e saj dhe nuk e di nëse ka qënë në fillim të muajit, në mes apo në fund të tij, atëherë themi se ajo duhet t’i referohet etapës së dytë që është bërja e dallimit, sepse e ka harruar ciklin e saj të zakonshëm dhe e ka të vështirë të mbështet tek ai. Prandaj ajo do t’i referohet bërjes se dallimit.

Prandaj themi: A ka ndryshuar gjaku yt? Nëse ajo thotë: “Po, një pjesë është i zi ose me aromë të keqe ose i trashë”. Atëherë i themi: Sa ditë vjen i zi, me erë të keqe ose i trashë?! Nëse ajo thotë: “Pesë ose gjashtë ditë”, atëherë i themi: Qëndro me menstruacione për këto ditë me këtë gjak, ndërsa për ditët e tjera pastrohu dhe fale namazin.

Nëse thotë se ky gjak i vjen vetëm për një ditë ose për 15 ditë, atëherë ai nuk merret në konsideratë, sepse nuk vlen për gjak menstruacionesh.

Fjala e autorit: “Nëse ajo nuk arrin të bëjë dallimin, atëherë do të qëndrojë aq kohë sa është shumica e ciklit të menstrual.”

Kjo do të thotë nëse asaj nuk i ndodh asnjë shenjë dalluese, si për shembull në rast se gjaku i saj nuk ndryshon, atëherë ajo do të qëndrojë me menstruacione aq kohë sa është pjesa më e madhe e cikleve menstruale. Për shembull, nëse një gruaje i vjen gjaku gjithmonë i zi ose gjithmonë i kuq etj.

Atëherë themi se ajo do të qëndrojë me menstruacione aq sa është

periudha më e zakonshme e cikleve menstruale, pra gjashtë ose shtatë ditë.

Qëndrimi më i saktë është ai që përmendëm, se në rastin e fillestares ajo do të referohet grave të saja të afërta dhe do të marrë në konsideratë ciklin e tyre duke filluar nga fillimi i muajit hënor dhe nuk themi që nga dita e parë që i vjen gjaku, sepse ajo e ka harruar ciklin e saj të zakonshëm.

Fjala e autorit: “...ashtu sikurse jo fillestarja, e cila e di kohën e ciklit por ka harruar numrin e ditëve.”

Kjo do të thotë se edhe gruaja që nuk është fillestare, e cila e di kohën kur i fillon cikli, por e ka harruar numrin e ditëve, do të qëndrojë me menstruacione për aq kohë sa është shumica e rasteve të ciklit menstrual dhe nuk do t'i referohet bërjes së dallimit.

Për shembull, kur një grua thotë se cikli i fillon në ditën e parë të muajit hënor, por ajo nuk e di nëse i zgjat gjashtë, shtatë apo dhjetë ditë. Pra ajo e di kohën kur fillon cikli, por ka harruar numrin e ditëve.

Atëherë themi se ajo duhet t'i referohet rasteve më të shpeshta të ciklit menstrual dhe do të qëndrojë me menstruacione për gjashtë ose shtatë ditë nga fillimi i muajit, sepse e di që cikli i fillon në fillim të muajit. U përmend më lart se ajo i referohet ciklit më të zakonshëm të grave të afërta me të, sipas qëndrimit më të saktë.

Fjala e autorit: “Por nëse e di numrin e ditëve dhe ka harruar ditën e fillimit në muajin përkatës”, kjo është e kundërta e çështjes së mëparshme; pra ajo e di numrin e ditëve, por nuk e di se kur fillon cikli.

Atëherë ne i themi asaj: “Sa ditë është cikli yt?!” Nëse ajo thotë gjashtë ditë, por e kam harruar nëse fillon në fillim, në mes apo në fund të muajit, atëherë i themi që ta fillojë nga fillimi i muajit sipas numrit të ditëve të ciklit të saj.

Fjala e autorit: “...edhe nëse është në gjysmë të muajit, e fillon ciklin nga dita e parë e muajit”, pra nëse ajo e di që cikli i fillon në gjysmë të muajit, por nuk e di me saktësi se në cilën ditë të gjysmës së muajit i fillon cikli; në ditën e 15-të apo në ditën e 20-të? Atëherë ajo do ta fillojë ciklin nga fillimi i muajit, sepse e ka humbur përcaktimin e datës së saktë dhe ky është qëndrimi i medh’hebit.

Qëndrimi i dytë është se ajo e fillon ciklin në fillim të gjysmës së muajit³³, sepse është më afër saktësisë se fillimi i muajit. Ky është qëndrimi i saktë.

Fjala e autorit: “është si ajo që nuk ka as cikël të zakonshëm dhe as mundësi për të bërë dallimin”, pra fillestarja, e cila nuk ka një cikël të përcaktuar dhe as mundësi për të bërë dallimin do të qëndrojë me menstruacione për aq kohë sa janë ciklet menstruale në përgjithësi, duke filluar nga fillimi i muajit.

Por qëndrimi i saktë në lidhje me fillestaren është se gjaku që del prej saj është gjak menstrual, për aq kohë sa cikli nuk zgjat më shumë se gjysma e muajit. Kjo do të thotë se kur fillestares t’i fillojë cikli, ajo do të qëndrojë ashtu derisa të pastrohet ose deri kur t’i kalojë 15 ditë.

Argumenti për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: **“Të pyesin ty për menstruacionet. Thuaj: “Ato janë një papastërti.”** (Bekare, 222) dhe në atë moment që ky gjak i papastër është prezent, atëherë ai është menstruacion pa marrë parasysh nëse është i paktë apo i shumtë. Si është e mundur që t’i thuhet asaj: Qëndro me menstruacione një ditë dhe një natë dhe pastaj merr gusël dhe falu, pastaj merr gusël sërish kur të ndërptitet për herë dytë, pastaj plotëso agjërimin?!

Kjo do të thotë se ne ua kemi obliguar adhurimin dy herë dhe guslin dy herë. Është e pamundur që Sheriati të sjellë të tilla dispozita, sepse adhurimet bëhen obligim vetëm një herë dhe jo më shumë.

Nëse gjaku i fillestares vazhdon të rrjedhë në shumicën e kohës, atëherë ajo është me Istihada dhe do t’i referohet bërjes së dallimit. Nëse nuk arrin ta bëjë, atëherë do t’i referohet ciklit të grave të afërta me të.

33 - Shiko: “El Insaf” 2/431

Ky është qëndrimi i saktë.

Fjala e autorit: “E kujt i zgjatet cikli i zakonshëm”, ka për qëllim të gjitha gratë.

Për shembull, nëse një grua e ka ciklin e zakonshëm pesë ditë dhe i zgjatet më shumë duke u bërë shtatë ditë.

Fjala e autorit: “ose i shpejtohet në kohë”, për shembull nëse një gruaje i fillon cikli në fund të muajit dhe më pas i vjen në fillim të muajit.

Fjala e autorit: “ose i vonohet”, për shembull nëse i fillon cikli në fillim të muajit dhe pastaj i vjen në fund të muajit.

Tri janë rastet e ndryshimit të ciklit menstrual: Shtimi, shpejtimi, vonimi dhe ka mbetur një rast i katërt që është pakësimi, të cilin do ta përmendi autori.

Fjala e autorit: “çfarë përsëritet tri herë është menstruacion”, ashtu si rasti i fillestares.

Një shembull për shtimin:

Ajo e ka ciklin pesë ditë, por i vijnë menstruacionet për shtatë ditë. Ajo do të qëndrojë me menstruacione vetëm pesë ditë, pastaj do të marrë gusël, do të falet dhe do të agjërojë. Kur të mbarojë rrjedhja, ajo do të marrë gusël për herë të dytë, ashtu si dhe fillestarja nëse ka menstruacione me shumë se periudha më e shkurtër, që është një ditë dhe një natë. Nëse vjen muaji i dytë dhe menstruacionet vazhdojnë për shtatë ditë, atëherë do të veprojë siç veproi muajin e parë. Nëse vjen muaji i tretë dhe ajo ka menstruacione për shtatë ditë, atëherë kjo periudhë kthehet në periudhën e ciklit të saj menstrual. Nëse ndodh kështu, atëherë ajo duhet të kompesojë atë çfarë duhet të kompesojë një grua me menstruacione për çfarë ka vepruar në muajin e parë. Në këtë mënyrë ajo duhet ta përsërisë (kompesojë) agjërimin e obligueshëm

nëse ka agjëruar në ato dy ditë, po ashtu edhe tavafin e obligueshëm, nëse ka bërë tavaf në ato dy ditë, sepse është bërë e qartë që në të vërtetë ajo ka qenë me menstruacione dhe gruas me menstruacione nuk i vlen agjërimi dhe as tavafi.

Kjo ngrihet mbi atë çfarë kemi thënë më lart në lidhje me fillestaren dhe u tha paraprakisht se qëndrimi i saktë është:

Fillestarja do të qëndrojë me menstruacione derisa të pastrohet. Nisur nga kjo, edhe nëse asaj i shtohen ditët me menstruacione, ajo nuk duhet të falet dhe të agjërojë dhe burri i saj nuk do të kërkojë marrëdhënie me të derisa ajo të pastrohet, të marrë gusël dhe të falet, sepse ajo ka gjak menstrual dhe nuk ka ndryshuar. Allahu i ka pasqyruar fare qartë për ne menstruacionet duke thënë: **“Të pyesin ty për menstruacionet. Thuaj: “Ato janë një papastërti.”** (Bekare, 222). Për aq kohë sa kjo papastërti është e pranishme, atëherë ajo është me menstruacione.

Një shembull për ardhjen më të shpejtë të menstruacioneve:

Ajo e ka ciklin e vet në fund të muajit, por kësaj radhe i vjen në fillim të muajit. Atëherë i themi: Prit dhe nëse përsëritet tri herë në këtë mënyrë, atëherë ato janë menstruacione. Në të kundërt, nuk janë asgjë.

Qëndrim i saktë është se ato janë menstruacione. Nëse cikli i saj ka qenë në fund të muajit dhe pastaj në muajin e dytë i vijnë në fillim të muajit, ajo duhet të qëndrojë me menstruacione, pa u falur, pa agjëruar dhe pa bërë marrëdhënie me bashkëshortin e saj.

Një shembull për ardhjen me vonesë të menstruacioneve:

Ajo e ka ciklin në fillim të muajit, por kësaj radhe i erdhën në fund të muajit. Sipas qëndrimit të autorit, nëse cikli i vjen në fund të muajit, atëherë ajo nuk ka menstruacione – edhe nëse ajo e njeh gjakun prej erës, trashësisë dhe ngjyrës së zezë që është gjak menstruacionesh-derisa kjo të përsëritet tri herë. Tani për tani ajo falet dhe agjëron. Nëse kjo situatë përsëritet tri herë, atëherë ajo duhet t’i kompesojë adhurimet (sepse ka qenë realisht me menstruacione në muajt që kaluan).

Qëndrimi më i qëlluar është se nëse cikli i saj vonohet, ajo është

menstruacione dhe se nëpërmjet përshkrimit të Allahut dihet që ato janë papastërta.

Fjala e autorit: “ajo që pakësohet nga cikli është periudhë pastërtie”, ky është ndryshimi i ciklit duke u pakësuar.

Për shembull, ajo e ka ciklin shtatë ditë, por pati menstruacione vetëm për pesë ditë dhe pastaj u pastrua. Ditët që u pakësuan janë ditë pastërtie, prandaj ajo duhet të marrë gusël, të falet dhe të agjërojë ditët e obliguara. Po ashtu edhe burri i saj mund të ketë marrëdhënie me të si të gjitha ditët e tjera kur ajo është e pastër.

Argumenti për këtë është si vijon:

- 1- Thënia e Allahut të Lartësuar: **“Dhe mos iu afroni atyre (grave tuaja) derisa të pastrohen dhe nëse pastrohen shkojuni atyre andej nga ju ka urdhëruar Allahu.”** (Bekare, 222)
- 2- Thënia e Profetit a.s.: *“A nuk është gruaja ajo që kur i vijnë menstruacionet as nuk falet dhe as nuk agjëron?!”* dhe kësaj gruaje i kanë mbaruar menstruacionet.

Dobi: Shenja e pastërtisë nga menstruacionet është e njohur për gratë. Bëhet fjalë për lëngun e bardhë që del në momentin kur ndalojnë menstruacionet. Disa gra nuk e kanë këtë lëng dhe qëndrojnë deri në menstruacionet e tjera pa arritur ta shohin atë. Atëherë, një nga shenjat e pastërtisë për këto gra është se nëse fusin një copë pambuk në vendin e rrjedhës së gjakut dhe e nxjerrin atë, do të shohin se pambuku nuk ka ndryshuar. Kjo është shenjë që ajo tashmë është e pastër.

Fjala e autorit: “Nëse cikli kthehet tek e zakonshmja, atëherë ajo do të qëndrojë po aq me menstruacione pa përsëritje”, pra nëse cikli rikthehet edhe një herë tek zakonet para, atëherë ajo do të qëndrojë me menstruacione pa patur nevojë që të përsëritet tri herë, sepse cikli i saj i zakonshëm është vërtetuar një herë dhe gjaku është rikthyer edhe një herë sipas periudhës së tij të parë. Për shembull, nëse ajo e ka patur ciklin e saj të zakonshëm gjashtë ditë

dhe në ditën e katërt u ndërpre dhe ajo u pastrua, papritur i vjen gjaku në ditën e gjashtë. Atëherë ajo do të qëndrojë me menstruacione në ditën e gjashtë, sepse është brenda periudhës së ciklit të saj. Por nëse gjaku kthehet në ditën e shtatë, atëherë ajo nuk do të qëndrojë me menstruacione, sepse dita e shtatë është jashtë ditëve të saj të ciklit të zakonshëm. U përmend më lart se në rast se cikli shtohet me ditë të tjera, atëherë nuk kemi të bëjmë realisht me menstruacione, vetëm nëse ky cikël përsëritet për tri muaj rresht. Ne përmendëm gjithashtu se cili është qëndrimi i saktë në këtë rast.

Fjala e autorit: “Sufra dhe kudra”.

Sufra dhe kudra janë dy lëngje që dalin nga gruaja, ndonjëherë para ciklit dhe ndonjëherë pas ciklit.

Sufra është një lëng i verdhë, si qelbi i plagëve.

Kudra është një lëng i përzier me ngjyrën e kuqe dhe ndonjëherë përziehet me damarë të kuq si mish i ngjizur. Ajo i ngjan ndryshkut dhe është e përzier me lëndë të bardhë dhe gjak.

Fjala e autorit: “Në kohën e ciklit ato janë mesntruacione”, pra nëse sufra dhe kudra vijnë në kohën e ciklit, atëherë ato janë menstruacione dhe nëse vijnë përpara ose pas ciklit, atëherë nuk janë të tilla. Ky është njëri nga qëndrimet në lidhje me këtë çështje.³⁴

Qëndrimi i dytë është se ato nuk janë menstruacione në mënyrë absolute, me argument thënien e Umu Atijes: *“Kudrën dhe sufrën e merrnim për asgjë.”*³⁵

Kuptimi i fjalës së saj “asgjë” do të thotë: nuk e konsideronim fare prej menstruacioneve. Kuptimi i fjalës së saj nuk është se kudra dhe sufra nuk kanë ndikim, sepse ato pa asnjë dyshim e prishin abdesin.

Qëndrimi i tretë është se ato janë pjesë e menstruacioneve në mënyrë absolute, sepse ato vijnë nga mitra dhe kanë aromë të keqe. Për këtë arsye ato kanë të njëjtin vlerësim si menstruacionet.

Për atë çfarë thotë autori, janë argumentuar me këto argumenta:

34- Në lidhje me qëndrimet e kësaj çështjeje shih: “El Mugni” 1/413, “El Insaf” 2/449, “El Mexhmu sherhul Muhedh-dheb” 2/395.

35- Buhariu 326.

- 1- Hadithi i përcjellë nga Ebu Daudi nga Umu Atijeh, që thotë: *“Kudrën dhe sufrën e merrnim për asgjë.”*³⁶ Ky kusht tregon se para pastrimit ato janë menstruacione.
- 2- Nëse kudra dhe sufra vijnë përpara se gruaja të pastrohet nga menstruacionet, atëherë ato do t'i nënshtrohen dizpozitave që kanë të bëjnë me menstruacionet, sepse në rregullat e fik'hut: *“Varësia i njihet asaj që nuk i vërtetohet pavarsia.”* Por, nëse ato vijnë pasi gruaja të jetë pastruar, atëherë ato janë ndarë e janë pavarsuar dhe gjaku i tyre nuk është më gjak për të cilin Allahu i Lartësuar thotë: **Thujaj: “Ato janë një papastërti.”** (Bekare, 222) dhe kështu ato konsiderohen lëngje si të gjitha lëngjet të cilat dalin nga organi i gruas dhe nuk ndjekin dispozitat e menstruacioneve.

Fjala e autorit: “Kush sheh një ditë gjak dhe një ditë pastrim, atëherë gjaku është menstruacion dhe pastrimi pastërti.”

Për shembull, një grua sheh një ditë gjak dhe një ditë tjetër pastrim. Kur u thirr ezani i akshamit, ajo pa gjak dhe kur u thirr akshami në ditën tjetër ishte e pastër. Dispozita lidhet gjithmonë me shkakun e saj, që do të thotë se për ditët që janë me menstruacione ato lëngje u nënshtrohen dispozitave të menstruacioneve dhe për ditët e pastrimit u nënshtrohen dispozitave të pastrimit pas menstruacioneve. Nisur nga kjo, ne e obligojmë gruan që të marrë gusël tri herë në gjashtë ditë.

Qëndrimi i dytë është se një periudhë kohore prej një ditë e gjysmë nuk mund të konsiderohet periudhë e pastër pa menstruacione³⁷, sepse zakonisht gratë gjatë ciklit të tyre shterojnë për një ditë dhe një natë. Edhe gjatë menstruacioneve ato nuk e vërejnë se ka ndodhur ndonjë pastrim dhe as e mendojnë veten e tyre të pastër në këtë periudhë. Përkundrazi, ato gjurmojnë gjithmonë kohën e daljes së gjakut. Nëse kjo që bëjnë gratë është pjesë e sjelljes së tyre të zakonshme, atëherë për ditën që ajo sheh se nuk ka rrjedhje gjaku gjykohej se ajo është ditë menstruacionesh dhe ajo nuk është e obliguar të marrë gusël, as të falet, as të bëjë tavaf dhe as të bëjë itikaf, sepse ajo është me menstruacione

36 - Ebu Daudi 307; El Hakim 1/174; Bejhakui 1/337 etj. El Hakim e ka vlerësuar të saktë sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit dhe këtë e mbështet edhe Dhehebiu.

37- Shiko: “El Mugni”, 1/437; “El Insaf” 2/453

derisa me të vërtetë të sigurohet që është pastruar.

Një fakt të tillë e konfirmon thënia e Aishes r.a. drejtuar grave kur i sillnin asaj pambuk që ta shihte nëse ishin pastruar apo jo: *“Mos u nxitoni derisa të shihni njollën e bardhë.”*³⁸ Pra, mos u nxitoni që të merrni gusël apo të faleni derisa të shihni njollën e bardhë.³⁹

Me të vërtetë që obligimi i gruas për të zbatuar qëndrimin e parë është shumë e lodhshme për të, sidomos në ditët e dimrit, gjatë udhëtimit etj. Ky është edhe qëndrimi më i saktë, ku pastrimi i përkohshëm për 20 orë apo për 24 orë nuk konsiderohet pastrim, sepse është një fenomen normal për gratë.

Fjala e autorit: “Për aq kohë sa nuk ka kaluar periudhën më të gjatë të menstruacioneve”, pra për aq kohë sa në total nuk kanë kaluar që të dyja periudhën më të gjatë të menstruacioneve dhe nëse e tejkalojnë, dmth 15 ditë, atëherë dalja e tyre është Istihada, sepse shumica e muajit kaloi me gjak.

Fjala e autorit: “Gruaja me Istihada apo me diçka të ngjashme me të...”

Sipas medh’hebit gruaja me Istihada është ajo që ka rrjedhje gjaku më shumë se gjysmën e muajit, pra më shumë se periudhën më të gjatë të menstruacioneve.

Thuhet gjithashtu se gruaja me Istihada është ajo që sheh gjak që nuk vlen për menstruacione apo për lehoni.⁴⁰

Sipas përkufizimit të fundit, kjo përfshin edhe atë grua që i rrjedh gjaku më shumë se një ditë dhe një natë, siç është fillestarja, sepse ai gjak nuk është as menstruacion dhe as lehoni. Në këtë mënyrë ajo është me Istihada derisa të përsëritet, siç u përmend më lart.

Sipas përkufizimit të parë, ai është gjak i prishur dhe duhet parë nëse

38- Buhariu 320, Maliku në ‘Muata’ 150.

39 - Shënim: njolla e bardhë në këtë rast mund të jetë pambuku i bardhë që del nga organi, i papërzier me ngjyra të tjera ose lëngu apo kokrriza e bardha që dalin nga gruaja pas përfundimit të menstruacioneve.

40 - Shiko: “Keshf el Kina” 1/207

do t'i bashkangjitet menstruacioneve apo Istihadës?

Fjala e autorit: "...apo me diçka të ngjashme me të" përfshin ato që vuajnë nga rrjedhjet e papastëriteve në mënyrë të vazhdueshme, si p.sh. ato që kanë rrjedhje urine apo jashtëqitje dhe i nënshtrohen të njëjtave dispozita si ato të gruas me Istihada.

Fjala e autorit: "...e lan organin e saj", d.m.th. me ujë dhe nuk mjafton pastrimi i organit vetëm me shami, letër etj., por duhet domosdoshmërisht që ta lajë derisa të pastrohet gjaku.

Nëse gruaja dëmtohet nga marrja e guslit ose mjekët e kanë vendosur diçka të tillë, atëherë ajo mund ta pastrojë me piceta të thata apo më diçka të ngjashme. Argument për këtë është thënia e Allahut të Lartësuar: **"...dhe mos i vrisni vetet tuaja."** (En-Nisa, 29) dhe thënia e Tij: **"Dhe mos u hidhni me duart tuaja drejt shkatërrimit."** (Bekare, 195)

Kush vuan nga rrjedhja e urinës e lan organin e tij, ndërsa ai që vuan nga nxjerrja e vazhdueshme e gazrave nuk e lan organin e tij, sepse gazrat nuk janë në statusin e papastërtisë.

Argumenti që tregon se ajo duhet ta lajë organin e saj është fjala e Profetit a.s. drejtuar Fatime bintu Hubjesh: *"Laje gjakun dhe falu."*⁴¹ Ky hadith tregon se organi duhet larë.

Fjala e autorit: "...dhe ta shtrëngojë me diçka", pra të pengojë rrjedhjen e gjakut me ndonjë fashë apo copë.

Atij që i rrjedh gjak nga vende të tjera përveç daljeve të jashtëqitjeve nuk e ka për obligim që të marrë abdes, përveç rasteve për të cilat ekziston qëndrimi se gjaku i shumtë e prish abdesin nëse ai del jo nga rrugët e jashtëqitjeve.

Qëndrimi më i saktë është se ai nuk e ka për obligim që të marrë abdes, sepse për çfarë del jo nga rrugët e jashtëqitjeve nuk ka asnjë argument

41- Buhariu 306; Muslimi 333.

që e prish abdesin dhe se origjina është vazhdimësia e pastërtisë.

Fjala e autorit: “...dhe ajo merr abdes për çdo kohë namazi”

do të thotë se për gruan me Istihada duhet që të marrë abdes në çdo kohë namazi nëse i rrjedh diçka dhe nëse jo, atëherë mbetet e pastër me abdesin e parë.⁴²

Fjala e autorit: “...dhe nuk kryhen marrëdhëniet me gruan me Istihada vetëm se në rastet kur frikësohet nga mundimi i tepërt”,

që do të thotë se me gruan me Istihada lejohen marrëdhëniet seksuale me të, vetëm në rastet kur moskryerja e marrëdhënieve i shkaktojnë asaj apo atij mundim. Ky është medh’hebi, vetëm se kja ndalesë nuk është si ndalesa e marrëdhënieve me gruan me menstruacione, siç do të sqarohet në vijim.

Ata janë argumentuar sa vijon:

- 1- Thënia e Allahu të Lartësuar: **“Të pyesin ty për menstruacionet. Thuaj: “Ato janë një papastërti.”** (Bekare, 222), ku Allahu i Lartësuar e ka bërë faktin që ky gjak është papastërti arsyen kryesore për të mos iu afruar grave dhe siç dihet, gjaku i Istihadës është papastërti.
- 2- Gjatë marrëdhënieve organi mashkullor ndyhet me gjak dhe gjaku është papastërti. Siç dihet, në zanafillë njeriu nuk mund të ketë kontakt të drejtpërdrejtë me papastërtinë, vetëm nëse është e nevojshme.

Por ndalimi i marrëdhënieve me gruan me Istihada është më i lehtë se ndalimi i marrëdhënieve me gruan me menstruacione, për disa arsye:

42 - Ky ka qenë qëndrimi i parë i shejhut tonë, por më pas ai është tërhequr nga ky qëndrim, duke thënë se qoftë në rastin e gruas me Istihada apo në raste të ngjashme, ku papastërtia është e vazhdueshme, nuk është e obligueshme për gruan që të marrë abdes për çdo namaz, por është mustehab. Dhe nëse merr abdes, abdesi nuk prishet vetëm me ndonjë rast tjetër. Ky është medh’hebi i imam Malikut, të cilin e ka përzgjedhur edhe Shejhul Islam, Ibn Tejmija, Allahu e mëshiroftë!, për shkak se nuk ka asnjë argument për prishjen e tij dhe se personi që ka papastërti të vazhdueshme nuk përfiton asgjë nga marrja e abdesit, sepse ai në vazhdimësi bëhet pis.

- 1- Përsa i përket ndalimit të marrëdhënieve me gruan me menstruacione, kjo është cituar nga Kurani Famëlartë, ndërsa ndalimi i marrëdhënieve me gruan me Istihada ose është bërë nëpërmjet analogjisë, ose me pretendimin se teksti kuranor e përfshin edhe atë.
- 2- Nëse burri apo gruaja kanë frikë se mundohen nëse nuk bëjnë marrëdhënie, atëherë lejohen marrëdhëniet me gruan me Istihada, ndryshe nga gruaja me menstruacione me të cilën nuk lejohen marrëdhëniet vetëm në rastet e domosdoshme.
- 3- Nëse lejohen marrëdhëniet me gruan me Istihada në raste mundimi, atëherë nuk ka asnjë shpagim për to, në kundërshtim me marrëdhëniet e gruas me menstruacione.

Qëndrimi i dytë: Nuk është e ndaluar⁴³ dhe ky është qëndrimi i saktë. Argumenti për këtë është:

- 1- Thënia e Allahut të Lartësuar: **“Gratë tuaja janë vendmbjellja juaj, prandaj shkojini vendmbjelljes tuaj si të dëshironi.”** (Bekare, 223)
 - 2- Për sahabet të cilët kishin bashkëshorte me Istihada, rreth 17 gra të tillë, nuk ka patur asnjë urdhër prej Profetit a.s. për asnjërin prej tyre që të distancohet nga gruaja e tij. Nëse diçka e tillë do të kishte qenë prej ligjit të Allahut, do ta kishte bërë të qartë i dërguari i Allahut a.s. për atë që kishin gra me Istihada dhe diçka e tillë do të ishte përcjellë tek ne për ruajtur Legjislacionin Islam. Por përderisa diçka e tillë nuk ka ndodhur, atëherë është bërë me dije se nuk është e ndaluar.
 - 3- Pafajësia në zanafillë, që është lejimi.
 - 4- Gjaku i Istihadës nuk është si gjaku i menstruacioneve; ato nuk përgjajnë as për nga natyra, as për nga dispozitat. Për këtë arsye, gruaja me Istihada duhet të falet. Nëse lejohet falja e namazit me këtë gjak, si nuk lejohet që të bëhen marrëdhënie me të? Ndalimi në rastin e namazit është më i madh se ndalimi për rastin e marrëdhënieve.
- Nga ana tjetër nuk mund ta marrim të mirëqenë që Istihada përfshihet tek ajeti i menstruacioneve, sepse Allahu i Lartësuar thotë: **“Të pyesin ty për menstruacionet. Thuaj: “Ato janë**

43 - Shiko: “El Insaf” 1/469

një papastërti.” (Bekare, 222). Përemri “ato” i referohet në veçanti vetëm menstruacioneve, që nënkupton: pra jo të tjerat, por vetëm ato janë papastërti. Edhe analogjia në pjesën më të madhe të dispozitave nuk qëndron. E si mund të qëndrojë, kur e tillë është kjo situatë?

- 5- Menstruacionet ndodhin në një periudhë të shkurtër kohore, në kundërshtim me Istihadën që mund të vazhdojë për një kohë të gjatë. Për këtë arsye, ndalimi i marrëdhënieve me gruan me Istihada me përjashtim të rasteve kur ata tremben se mos bëra e tyre i lëndon është mjaft e sikletshme dhe krijimi i sikletit në Sheriat është i papëlqyer.

Përsa i përket ndotjes së organit të burrit me gjakun e Istihadës gjatë marrëdhënieve, themi se është e tolerueshme nëse kemi të bëjmë me një ndotje jo të madhe, sepse sasia e gjakut që mbetet në organin gjenital është shumë e vogël. Por edhe nëse thuhet se nuk tolerohet, përsëri ai mbetet një kontakt i paqëllimtë dhe jo i vazhdueshëm me gjakun, i cili më vonë duhet të lahet dhe të pastrohet.

Nëse gjaku i Istihadës është i përshirë për bashkëshortin dhe nuk ai nuk i parapëlqen marrëdhëniet duke para gjakun, kjo mbetet një çështje personale mbi të cilën nuk mund të ngrihen dispozita fetare. Ndonjëherë njeriu mund të mos i pëlqejë disa gjëra për shkak të shijeve personale dhe nuk mund të kritikohet nëse e braktis atë gjë, ashtu sikurse nuk i pëlqeu të dërguarit të Allahut a.s. ngrënia e mishit të dabit (hardhucës së shkretëtirës), edhe pse ngrënia e mishit të tij është e lejuar dhe tha: *“Ky nuk njihet në tokën e popullit tim, prandaj unë nuk e pëlqej atë.”*⁴⁴

Fjala e autorit: “...është mustehab marrja e guslit prej saj për çdo namaz.”

D.m.th. gruaja me Istihada merr gusël sa herë që hyn koha e një namazi dhe jo sa herë fal namaz. Argument për këtë është urdhërimi i Profetit a.s. për diçka të tillë.⁴⁵

44- Buhariu 5400; Muslimi 1945.

45- Buhariu 327; Muslimi 334.

Nëse ajo ka vullnet edhe mund të lahet për çdo namaz, por në të kundërt ajo mund të bashkojë drekën me ikindinë dhe akshamin me jacinë dhe në vend që të lahet pesë herë, lahet vetëm tri herë; një herë për drekën dhe ikindinë, një herë për akshamin dhe jacinë dhe një herë për sabahun.

Ky gusël nuk është vaxhib, por gusli që është vaxhib është ai që bëhet menjëherë pasi ka përfunduar cikli menstrual. Çdo gusël tjetër përveç tij është sunet.

Kjo larje ka edhe dobitë e veta mjekësore, sepse ndihmon në tkurrjen e enëve të gjakut dhe nëse ato tkurren, fillojnë edhe mbyllen dhe kështu ndalon rrjedhja e gjakut. Ndoshta me marrjen e guslit Istihada ndalon, sepse ajo nuk është gjë tjetër veçse gjak damari dhe ky i fundit ngrin në të ftohtë.

ጸጋ

Lehonia
(*Nifasi*)

ጸጋ

Fjala e autorit: “Periudha më e gjatë e lehonisë është dyzet ditë”

Lehonia është kategoria e fundit e gjakrave, të cilat janë tri lloje: menstruacionet, Istihada dhe lehonia. Disa të tjerë shtojnë edhe një kategori tjetër që është gjaku i prishur, ndërsa disa të tjerë e përfshijnë këtë fundit tek Istihada.

Lehonia në arabisht quhet “nifas”, një fjalë që vjen nga “nefesi”, që është rrugëdalje dhe zgjidhja, sepse me ardhjen e lehonisë gruaja gjen lehtësi dhe shpëtim nga mundimet e veta.

Nuk ka dyshim se gruaja stërmundohet gjatë shtatzënisë dhe gjatë lindjes, siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Atë e ka mbajtur nëna e vet dobësi pas dobësie”** (Lukman, 14) dhe **“...e ka mbajtur nëna e vet me mundim dhe ka lindur me mundim.”** (Ahkaf, 15)

Lehonia është gjak që del nga gruaja pas lindjes, gjatë saj ose para saj, me dy ose tre ditë e shoqëruar me kontraksione ose pa to, ndërsa ajo çfarë del para lindjes është gjak i prishur, nuk është asgjë.

Nëse diksuh pyet, se si mund ta njohim lehoninë para lindjes me dy ose tri ditë? Bëhet fjalë për rastin kur gruaja ka filluar t’i ndjejë kontraksionet dhe gjaku ka filluar të dalë prej saj, por a mund ta dimë që ajo do të lindë për dy ose tri ditë?

Përgjigja është se nuk e dimë. Në origjinë ajo nuk konsiderohet lehonë, por kemi një dukuri që qëndron mbi origjinën që janë kontraksionet, të cilat janë prova të tërthorta që ky gjak është gjak lehonie dhe se lindja është afër. Nisur nga kjo, atëherë ajo do të qëndrojë si grua lehonë dhe nuk falet. Nëse tejkalohen dy ditë, atëherë do ta kompesojë periudhën e tepërt, sepse u bë e qartë se ditët e tepërta nuk ishin ditë lehonie dhe gjaku ishte gjak i prishur.

Disa dijetarë kanë thënë se nuk mund të ketë lehoni vetëm se me lindje ose pas saj. Ajo çfarë sheh gruaja para lindjes – qoftë edhe e shoqëruar me kontraksione – nuk është lehoni.⁴⁶

Nisur nga ky qëndrim gruaja qëndron e qetë, falet dhe agjëron edhe nëse sheh gjak dhe ka kontraksione. Çdo gjë është në rregull. Ky

46- Shiko: “El Insaf” 2/392, 481

është qëndrimi i shafive⁴⁷ dhe e përmenda, sepse është një qëndrim mjaft i argumentuar, sepse deri më tani gruaja ende nuk është çliruar, ndërkohë që lehonja vjen për ta çliruar.

Mesele: A mund të jetë lehoni çdo gjak që del nga organet e gruas?

Përgjigja: Kjo ndahet në disa situata:

E para: Nëse gruaja nxjerr pikë gjaku. Ky është gjak i prishur dhe nuk është lehoni.

E dyta: Nëse gruaja nxjerr fetusin që i ka mbushur katër muaj. Kjo është lehoni dhe për këtë ka pajtim, për arsye se fetuesit i ka hyrë shpirti dhe jemi të sigurtë që tashmë ai është një njeri. Këto dy aspekte gëzojnë pajtim dhe midis tyre ka edhe vend për diskutim.

Së treti: Nëse gruaja nxjerr një copë mishi të paformësuar dhe për këtë ka mospajtim:

Qëndrimi i njohur në medh'heb është se kjo nuk përbën as menstruacione dhe as lehoni. Disa njerëz të dijes thonë se kjo është lehoni⁴⁸.

Ata argumentohen me faktin se gjaku mund të prishet dhe të mos dalë një foshnjë prej tij. Nëse kthehet në një copëz mishit të ngjizur, atëherë jemi të sigurtë që ai është një njeri, prandaj dhe gjaku i gruas është gjak lehonie.

Së pesti: Nëse gruaja nxjerr një copë mishi të formëzuar, aq sa është e mundur të dallohet koka, dy duart dhe këmbët e tij. Pjesa dërrmuese e njerëzve të dijes – sikurse është edhe qëndrimi më i njohur i medh'hebit – është se kjo është lehoni.

Ata janë argumentuar me faktin nëse fetusin del dhe ende nuk është formëzuar, atëherë ka mundësi të jetë gjak i ngrirë ose një copë mishi që nuk të jep përshtypjen e një njeriu. Kjo ka probabilitetin për të mos qenë lehoni, sepse lehonja ka dispozitat e veta përkatëse, ku ndër to është rrëzimi i detyrimit për faljen e namazit dhe agjërimin, si ndalimi i bashkëshortit për të bërë marrëdhënie me të. Prandaj nuk mund t'i fusim në fuqi këto dispozita vetëm duke u siguruar më parë dhe nuk mund të sigurohemi derisa të bëhet e qartë se fetuesi është formëzuar në njeri.

Periodha më e shkurtër ku bëhet e qartë formëzimi i një njeriu është

47 - Shiko: El Mexhmu'u sherhul Mehedh-dheb" 2/521

48 - Shiko: "El Insaf" 2/481

81 ditë, me argument hadithin e përcjellë nga Ibn Mesudi r.a.: "...si pikë uji për dyzet ditë, e pastaj bëhet gjak i ngjizur (mpiksuar) po për aq ditë..."⁴⁹

Këto të gjitha janë 80 ditë dhe pastaj Profeti a.s. thotë: "...e pastaj bëhet një copë mishi" dhe kështu fillohet nga dita e 81-të.

Nëse fetusin bie në më pak se 80 ditë, atëherë nuk ka lehonin dhe gjaku që del gëzon dispozitat e Istihadës.

Nëse gruaja lind në ditën e 81-të, atëherë duhet të sigurohemi, nëse është i formëzuar apo jo, sepse Allahu i Lartësuar e ka ndarë copën e mishit në të formëzuar dhe të paformëzuar, ku thotë: **"një copë mishi e formëzuar dhe e paformëzuar"** (El Haxh, 5). Në këtë mënyrë ekziston mundësia që ajo të jetë e paformësuar.

Në shumicën e rasteve nëse shtatzënia i kalon 90 ditë, atëherë forma njerëzore e fetusit është e qartë dhe duke u bazuar mbi këtë fakt, nëse gruaja lind në ditën e 90-të, atëherë gjaku që del është lehonin në shumicën e rasteve. Ndërsa pas 90 ditëve konfirmohet nëse ai është fëmijë dhe se gjaku është gjak lehonie, ndërsa para 90 ditëve ka nevojë për konfirmim.

Nëse gruaja ka lehonin, ka mundësi që të mos e shohë gjakun dhe kjo ndodh shumë rrallë. Nisur nga kjo, ajo nuk do të qëndrojë me lehonin për të gjithë periudhën (40 ditë), por nëse lind gjatë lindjes së diellit dhe pastaj hyn koha e drekës dhe ajo ende nuk ka parë gjak, atëherë ajo nuk merr gusël, por merr abdes dhe falet.

Nëse gruaja lehonë e sheh gjakun për dy, dhjetë, njëzet, tridhjetë apo dyzet ditë, atëherë ajo është lehonin dhe nëse shkon përtej kësaj periudhe ajo nuk është më me lehonin sipas medh'hebit, sepse periudha më e gjatë e lehonisë është dyzet ditë.

Për këtë qëndrim ata janë argumentuar me një transmetim nga Umu Seleme r.a., që ka thënë: *"Gruaja lehonë qëndronte e tillë për dyzet ditë në kohën e Profetit a.s."*⁵⁰

Një pjesë e dijetarëve e kanë vlerësuar të dobët këtë hadith dhe disa të tjerë e vlerësojnë hadith të mirë (hasen). Ky hadith mbështet edhe nga transmetime të tjera, të cilat e ngrejne lart gradën e tij në hadith hasen.

49 - Përcillet nga Abdullah bin Mesudi r.a. se ka thënë: "Na ka treguar i dërguari i Allahut a.s., dhe ai është njeriu që thotë vetëm të vërtetën, se: "Secilit prej jush i mblidhet krijimi në barkun e nënës së vet si pikë uji për dyzet ditë, e pastaj bëhet gjak i ngjizur (mpiksuar) po për aq ditë, e pastaj bëhet një copë mishi po për aq ditë dhe pastaj tek ai dërgohet engjëlli, i cili urdhërohet për katër fjalë: që të shkruajë rrizkun e tij, vdekjen e tij, veprat e tij dhe nëse do të jetë i dëshpëruar apo i lumtur. Më pas atij i fryhet shpirti." Buhariu; 6594, Muslimi 2643 pa fjalën "pikë uji."

50 - Ahmedi 6/300, 304, 309, 310; Ebu Daudi 316, Tirmidhiu 139, Ibn Maxheh 648; Hakemi 1/175.

Ekziston mundësia që kuptimi i tij të jetë se, periudha më e gjatë e lehonisë ishte 40 ditë dhe gjithashtu ekziston mundësia që kjo të ketë qenë periudha më e shpeshtë.

Sipas qëndrimit të parë, nëse ajo i plotëson dyzet ditë dhe gjaku ende vazhdon të dalë, ajo duhet të marrë gusël, të falet dhe të agjërojë, përveç rastit nëse kjo përkon me periudhën e ciklit të saj menstrual dhe rrjedhja gjakut është menstruacion, sepse periudha më e gjatë e lehonisë është dyzet ditë.

Sipas qëndrimit të dytë, ajo do të vazhdojë të jetë lehonë derisa të plotësojë gjashtëdhjetë ditë. Ky është qëndrimi i Malikut⁵¹ dhe Shafiut⁵². Për këtë ka folur edhe Ibn Akili duke e përcjellë nga Ahmedi⁵³.

Ata janë argumentuar se referenca në këtë rast është fakti që ka ndodhur dhe që janë gjetur gra të cilat kanë patur lehonë deri në gjashtëdhjetë ditë. Përsa i përket hadithit të Umu Selemesë, ata e kanë konsideruar që bën fjalë për një periudhë që ndodh në shumicën e rasteve tek gratë. Për qëndrimin e tyre flet edhe fakti që ka gra të cilave u vazhdon lehonja edhe pas dyzet ditëve duke ruajtur natyrën, erën dhe intesitetin e njëjtë.

Për shembull, nëse gruaja lind në orën 12-të pas dreke dhe i plotëson 40 ditë në orën 12-të të ditës së dyzet, si mund të thuhet që në orën 12-të pa pesë të ditës së dyzetë gjaku i saj është gjak lehonie, ndërsa në orën 12-të e pesë minuta të të njëjtës ditë gjaku i saj është gjak pastrimi? Suneti Profetik nuk sjell të tilla diferenca pa patur një element që bën dallimin.

Dikush mund të thotë se e njëjta logjikë mund të vlejë edhe për mendimin se lehonja është 60 ditë.

Përgjigja është: Këto janë qëndrimet më të shumta që janë mbajtur nga dijetarët me konsideratë, edhe pse disa dijetarë kanë thënë se periudha më e gjatë e lehonisë është 70 ditë, por ky është një qëndrim i dobët dhe një përjashtim.

Qëndrimi më i qëlluar që mendoj unë është se, nëse gjaku është i vazhdueshëm me të njëjtin intesitet, ajo do të qëndrojë lehonë derisa të plotësojë 60 ditë pa i tejkaluar ato.

Sipas dy përcaktimeve, 40 dhe 60, sipas qëndrimit të dytë, themi se nëse përkojnë me ciklin menstrual, atëherë ato janë menstruacione.

Për shembull, një grua i plotësoi 40 ditë në ditën e parë të muajit dhe

51 - Shiko: "Hashija e Desukiut për Esh-sherh el Kebir" 1/174

52 - El Muxhmu'u 2/524.

53 - Shiko: "El Insaf" 2/471

cikli i saj menstrual para shtatzënisë fillonte në ditën e parë të muajit deri në gjashtë ditë. Nëse gjaku vazhdon të rrjedhë nga dita e parë deri në ditën e gjashtë, atë do ta konsiderojmë gjak menstrual, sepse përkon me ciklin e saj. Kur ai e tejkalon periudhën më të gjatë të lehonisë, atëherë ai i nënshtrohet dispozitave të Istihadës. E përmendëm më lart se, gruaja me Istihada që ka patur një cikël të rregullt do t'i referohet ciklit të saj të zakonshëm dhe kështu ne e referojmë tek cikli i saj i zakonshëm.

Nëse nuk përkon me ciklin, atëherë gjaku i saj është gjak i prishur, prandaj ajo nuk mund ta lërë namazin dhe agjërimin prej tij. Lehonja nuk ka një kufi për periudhën më të shkurtër, ndryshe nga menstruacionet, që sipas qëndrimeve të dijetarëve e ka periudhën më të shkurtër një ditë dhe një natë, ndërsa lehonja nuk ka një kufi për periudhën e saj më të shkurtër.

Fjala e autorit: “Kurdo që gruaja të pastohet para saj”, pra kurdo që lehona të pastrohet përpara se të përfundojë periudha më e gjatë e lehonisë, duke iu ndërprerë gjaku, sepse gruaja e njëh momentin kur pastrohet.

Fjala e autorit: “ajo pastrohet” d.m.th. merr gusël.

Fjala e autorit: “dhe falet” d.m.th. farzet dhe nafilet; e para si detyrim dhe e dytat si vepër e pëlqyeshme.

Fjala e autorit: “dhe nuk është e pëlqyeshme që të kryhen marrëdhënie me të para dyzet ditëve pasi të pastrohet” d.m.th. nuk pëlqehet që të kryhen marrëdhënie me të nëse pastrohet para dyzet ditëve.

Ata janë argumentuar si më poshtë:

- 1- Përcillet se Othman bin ebi El Asi r.a. i tha gruas së vet kur i erdhi e pastër para dyzet ditëve: “Mos mu afro!”⁵⁴ dhe

54 - Abdurrezaku në “Musanafin” e vet nr. 1202 dhe Dal el Kutni ne “Sunen” 1/219 nr. 842 përrjellin nga El Hasani, e ky nga Othman bin ebi El Asi se njëres prej grave të veta i thoshte: “Mos mu afro para dyzet ditëve.”

Othmani ishte njëri prej sahabeve. Fjala e tij “mos mu afro” është ndalesë, ose së paku mekreh (e papëlqyeshme).

- 2- Frika se mos gjaku kthehet përsëri, sepse periudha është periudhë lehonie.

Ata i kanë nxjerrë marrëdhëniet jashtë dispozitës së tyre themelore -që është ndalesa në rast se gjaku vazhdon të rrjedhë- drejt mekruhut (mospëlqimit) në rast se ai ndërpritet, për shkak se arsyeja e ndalesës, që është gjaku, nuk ekziston më. Po përse të mos e nxjerrim nga ndalesa në lejesë? Marrëdhëniet me lehonën ose janë të ndaluara, ose janë të lejuara, ndërsa t'i vlerësosh si të papëlqyeshme kjo ka nevojë për argument dhe në këtë rast nuk ka argument.

Qëndrimi më i qëlluar është se lejohen marrëdhëniet me të para dyzet ditëve nëse ajo pastrohet.

Përsa i përket qëndrimit të Othman bin ebi El Asit, i jepet përgjigja si vijon:

- 1- Ai është një transmetim i dobët.
- 2- Ai mund të largohet nga marrëdhëniet pa qenë të papëlqyeshme për të, sepse mungesa e dëshirës së tij nuk tregon që marrëdhëniet me lehonën që është pastruar pa mbushur 40 ditë janë të papëlqyeshme.
- 3- Ndoshta qëndrimi i tij është thjesht për të qenë më i sigurtë, sepse është e mundur që ajo ta ketë parë pastrimin ose jo, ose është e mundur gjithashtu që gjaku të zbresë për shkak të marrëdhënieve.

Fjala e autorit: “Nëse asaj i kthehet gjaku” d.m.th. nëse lehonës i kthehet gjaku pasi ishte ndërprerë.

Fjala e autorit: “është i dyshimtë” d.m.th. nuk e dimë nëse është gjak lehonie apo gjak i prishur. Nëse është gjak lehonie, ajo mbetet lehonë dhe nëse është gjak i prishur, atëherë ajo nuk e ka statusin e lehonës.

Fjala e autorit “atëherë ajo agjëron dhe falet” d.m.th. ajo duhet të marrë gusël, të falet dhe të agjërojë nëse përkon me Ramazanin, por nga ana tjetër ajo duhet të shmanget nga veprat që i ndalohen gruas lehonë, siç janë marrëdhëniet dhe nuk i bën ato, sepse ne e urdhërojmë që të veprojë veprat e obligueshme si namazi dhe agjërimi për të qenë të sigurtë, sikurse e ndalojmë atë nga veprat e ndaluara gjithashtu për të qenë të sigurtë.

Fjala e autorit: “dhe shlyen veprat e obligueshme” d.m.th. agjërimin dhe namazin nëse mund të shlyhen.

Për shembull, një grua e pati ditën e pastrimit në ditën e dhjetë të Ramazanit, teksa ka kaluar njëzet ditë lehonie. Kjo do të thotë se ajo ka lindur dhjetë ditë para Ramazanit dhe është pastruar në ditën e dhjetë të Ramazanit. Ajo vazhdoi e pastër deri në ditën e njëzet të Ramazanit, por më pas gjaku iu kthye në dhjetëditëshin e fundit të Ramazanit. Ajo duhet të falet dhe të agjërojë për siguri, sepse ekziston mundësia që ai të mos jetë gjak lehonie.

Më pas ajo u pastrua kur plotësoi dyzet ditët, pra në ditën e Bajramit. Kështu ajo duhet të marrë gusël dhe të kompesojë agjërimin që ka kryer në kohën që kishte gjak, sepse ekziston mundësia që ai të ketë qenë gjak lehonie dhe agjërimi nuk është i vlefshëm kur gruaja ka gjak lehonie.

Ndërsa ato ditë që i ka agjëruar kur ishte e pastër – që janë ditës midis ditës së dhjetë dhe të njëzetë në muajin e Ramazanit – nuk do t'i shlyejë, sepse i ka agjëruar ato teksa ishte e pastër dhe nuk kishte gjak.

Përsa i përket namazit, ajo nuk e ka për detyrim që të shlyejë ato namaze që i ka falur pas iu kthye gjaku, sepse nëse do të ishte gjak i prishur ajo i ka falur dhe i ka shlyer detyrimet, e nëse do të ishte gjak lehonie, ajo nuk e ka për detyrë që t'i falë ato, sepse namazi nuk është i obligueshëm për gratë lehona.

Në këtë mënyrë, dispozita e gjakut të dyshimtë bëhet e atillë që gruaja e ka për detyrë të veprojë ashtu siç veprojnë gratë e pastërta për shkak të probabilitetit që gjaku të jetë gjak i prishur, dhe të shlyejë ato detyrime që ka për detyrë t'i shlyejë gruaja lehonë për shkak të probabilitetit

që gjaku ky gjak mund të jetë gjak lehonie. Këtë e thotë autori dhe ky është qëndrimi i medh'hebit.

Qëndrimi më i qëlluar është se, nëse gjaku i rikthyer është gjak lehonie për nga ngjyra, për nga aroma dhe për nga të gjitha karakteristikat, atëherë ai nuk është një gjak i dyshimtë, por një gjak i njohur. Ajo është lehoni, prandaj gruaja as nuk agjëron dhe as nuk falet. Ajo gjithashtu e shlyen agjërimin, por jo namazin.

Nëse gruaja arrin të mësojë përmes provave të tërthorta se ai nuk është gjak lehonie, atëherë ajo është në statusin e grave të pastra, agjëron dhe falet pa i shlyer ato, sepse Allahu nuk i ngarkuar njerëzit që ta kryejnë adhurimin dy herë; pra ose do të ketë të drejtë që të agjërojë, ose nuk do të ketë të drejtë, por në rast se gjaku i rikthyer përkon me ciklin e saj menstrual, atëherë ajo është me menstruacione.

Fjala e autorit: “lehona është si gruaja me menstruacione përsa i përket lejimeve” d.m.th. që dispozita e gruas lehonë është e njëjtë me gruan me menstruacione përsa i përket gjërave të lejuara, siç është të kënaqur e burrit me gruan e tij në mënyra të tjera përveç marrëdhënieve, ecja nëpër xhami nëse ajo është e sigurtë që nuk e ndot atë etj..

Fjala e atij: “dhe përsa i përket të ndaluarave” d.m.th. që dispozita e gruas lehonë është e njëjtë me atë të gruas me menstruacione përsa i përket gjërave të ndaluara, si p.sh. agjërimi, namazi, marrëdhëniet, tavafi, divorci etj. sipas qëndrimit të autorit.

Fjala e autorit: “obligimeve” d.m.th. edhe obligimet janë të njëjta si ato të gruas me menstruacione.

Fjala e autorit: “dhe obligimeve që bien” d.m.th. obligim që bien janë të njëjta me ato të gruas me menstruacione, siç është agjërimi, namazi, të cilat bien si detyrime, por agjërimi shlyhet, ndërsa namazi jo.

Fjala e autorit: “përveç periudhës së pritjes (pas divorcit ose vdekjes së burrit)”, d.m.th. që lehona ndryshon nga gruaja me menstruacione përsa i përket periudhës së pritjes pas divorcit.

Menstruacionet përllogariten të përfshira në periudhën e pritjes, ndërsa lehonia jo. Për shembull, nëse një burrë e divorcon gruan e tij, atëherë periudha e pritjes së saj është tri cikle menstruale, ku secila prej tyre përllogaritet si pjesë e periudhës së pritjes. Ndërsa përsa i përket lehonisë, ajo nuk është pjesë e periudhës së pritjes, sepse nëse burri divorcon gruan e tij përpara se të lindë, periudha e pritjes mbaron në momentin që ajo lind. Nëse e ai e divorcon dhe ajo pret tri cikle menstrualë, lehonia nuk ka asnjë lidhje me këtë periudhë.

Fjala e autorit: “pubertetit” d.m.th. që lehonia ndryshon nga cikli menstrual përsa i përket pubertetit (bylykut) që do të thotë se menstruacionet janë shenjë e pubertetit. Shtatzënia nuk mund të jetë shenjë e pubertetit, sepse nëse ajo është shtatzënë, atëherë ne e mësojmë se ajo ka patur menstruacione dhe kështu puberteti i saj është bërë realitet përmes menstruacioneve të saja të mëparshme.

Edhe betimi për lënien e marrëdhënieve seksuale përjashtohet gjithashtu, pra kur burri betohet se nuk do të bëjë kurrë marrëdhënie me gruan e tij ose për më shumë se katër muaj. Për shembull, nëse ai thotë: “Pasha Allahun, nuk do të bëj marrëdhënie me gruan time” ose “Pasha Allahun, nuk kam për të bërë marrëdhënie me gruan time derisa të dalë Dexhali.”

Këtij do t’i numërohen katër muaj dhe nëse kthehet nga betimi i tij dhe bën marrëdhënie me gruan, atëherë e ka prishur betimin, por nëse nuk kthehet, atëherë kur të plotësohet afati i thuhet: “Ose tërhiq nga betimi, ose divorcoje gruan.”

Nëse ai thotë se gruaja e tij ka menstruacione dhjetë ditë në muaj dhe kanë mbetur edhe dyzet ditë nga afati i betimit, dhe kërkon që këto ditë t’i zbrësë nga afati i betimit, atëherë i thuhet: “Ditët e menstruacioneve nuk bien, por do të të llogariten.”

Ndërsa përsa i përket lehonisë, ato nuk llogariten në afatin e betimit.

Për shembull, nëse ai betohet se nuk do të bëjë marrëdhënie me gruan e tij kur ajo është në muajin e nëntë të shtatzënisë, atëherë atij i llogariten katër muaj. Kur gruaja e tij lind dhe kalojnë katër muaj nga afati që i kemi përlllogaritur, atëherë do t'i themi atij: “Ose divorcoje, ose kryej marrëdhënie.” Nëse ai thotë se gruaja e tij ka kaluar dyzet ditë lehonit, të cilët dëshiroj që t'i zbres nga afati, atëherë ne ia zbresim nga afati dhe i shtojmë atij edhe dyzet ditë të tjera. Nëse ajo qëndron lehonë për gjashtëdhjetë ditë, atëherë i zbresim atij gjashtëdhjetë ditë.

Pra, ky është dallimi midis menstruacioneve dhe lehonisë. Njerëzit e dijes kanë thënë⁵⁵ se dallimi midis menstruacioneve dhe lehonisë është fakti se lehonitë është një çështje e zakonshme dhe Allahu i ka dhënë këtij burri një afat prej katër muajsh e dhjetë ditë, teksa Ai e di fare mirë se pjesa më e madhe e grave kanë menstruacione çdo muaj. Ndërsa lehonitë është një fenomen i rrallë, ku situata është e atillë që burri i cili ka bërë betimin nuk ka prirje për tek gruaja e tij në gjendjen e lehonisë dhe gjakut. Megjithatë, kjo është një çështje që nuk i shpëton qëndrimeve të ndryshme.⁵⁶

Një tjetër dallim midis tyre është se gruaja me menstruacione të rregullta gjashtë ditore, nëse pastrohet plotësisht, natë e ditën, për katër ditë dhe pastaj i kthehet gjaku sërish në periudhën e mbetur prej një dite dhe një nate, ajo ka ende statusin e gruas me menstruacione, ndërsa në rastin e lehonisë, nëse gjaku i rikthehet brenda periudhës së vet, ai ka status të dyshimtë. Ky është qëndrimi i medh'hebit.

Një tjetër dallim është mospajtimi në medh'heb, nëse divorci ndodh gjatë ciklit menstrual, a merret në konsideratë? Për këtë ka mospajtim.⁵⁷

Në rastin e lehonisë – sipas medh'hebit- është gjithashtu e ndaluar, ***siç thotë autori: “... lehona është si gruaja me menstruacione përse i përket lejesave dhe ndalesave”***, sepse i dërguari i Allahut a.s. i tha Omerit r.a.: “*Udhëroje që ta ktheje (gruan e divorcuar), pastaj le ta divorcojë kur të jetë e pastër ose shtatzënë*”⁵⁸ dhe lehona nuk është e pastër.

Qëndrimi i saktë është se nuk është e ndaluar.

Argumenti për këtë është se divorci në periudhën e ciklit menstrual

55 - Shiko: “El Mugni” 11/34

56- Shiko: “El Insaf” 23/193

57- Shiko: “El Mugni” 10/327; “Mexhmul Fetava” 33/21.

58- Buhariu 4908; Muslimi 1471

është ndaluar për shkak se bëhet jashtë periudhës së pritjes. Allahu i Lartësuar thotë: **“O ti pejgamber, kur t’i lëshoni gratë, lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë së tyre)”** (Talak, 1). Nëse gruaja divorcohet kur është me menstruacione, atëherë ky cikël nuk llogaritet dhe ajo duhet të kalojë tri cikle të reja dhe nuk hyn në periudhën e pritjes menjëherë pas dhënies së divorcit.

Përsa i përket lehonisë, ajo nuk ka asnjë lidhje me periudhën e pritjes dhe nuk llogaritet prej saj. Nëse burri e divorcon gruan gjatë lehonisë, ajo e fillon menjëherë periudhën e pritjes dhe konsiderohet e divorcuar me mbarimin e saj. Nëse është kështu, atëherë nëse e ai divorcon gjatë lehonisë ose pas saj, të gjitha janë njëlloj.

Thënia e Profetit a.s.: *“...pastaj le ta divorcojë kur të jetë e pastër ose shtatzënë”* do të thotë e pastër nga menstruacionet, me argument tekstin e përcjellë në hadith: *“Ai e divorcoi gruan e tij teksa ishte me menstruacione”* dhe sepse i dërguari i Allahut a.s. lexoi ajetin: **“...lëshoni ato në vigjilje të fillimit të pritjes së tyre (në kohën e pastërtisë së tyre)”**. Kësisoj, kjo dispozitë është e veçantë për divorcin gjatë menstruacioneve dhe nuk i përket lehonisë.

Gjithashtu, një nga dallimet mes menstruacioneve dhe lehonisë është se nuk është e pëlqyeshme që të kryhen marrëdhënie me lehonën përpara se të plotësojë dyzet ditë, sipas qëndrimit më të njohur në medh’heb dhe kjo nuk vlen për marrëdhëniet me gruan me menstruacione nëse pastrohet përpara mbarimit të ciklit të zakonshëm të saj.

Një dallim tjetër është se nuk ka një periudhë më të shkurtër për lehoninë, ndërsa për menstruacionet ka.

Pra këto janë shtatë dallimet midis menstruacioneve dhe lehonisë.

Fjala e autorit: “Nëse ajo lind binjakë” d.m.th. dy fëmijë.

Fjala e autorit: “periudha e lehonisë së saj fillon dhe mbaron mbi bazën e lindjes së të parit” d.m.th. me fëmijën e parë që lind, edhe nëse midis tyre ka një diferencë kohore dy ose tri ditë. Nëse supozojmë se ajo e lind fëmijën e parë në ditën e parë të muajit dhe të

dytin në ditën e dhjetë, atëherë asaj i mbeten edhe tridhjetë ditë lehonit, sepse fillimi i lehonisë llogaritet që me lindjen e parë.

Nëse supozojmë se ajo e lind fëmijën e parë në ditën e parë të muajit dhe të dytin në ditën e dhjetë të muajit pasardhës, atëherë ajo nuk ka më lehonit për fëmijën e dytë, sepse lehonit e saj fillon me lindjen e fëmijës së parë dhe ajo i ka plotësuar dyzet ditë. Kësisoj, lehonit e saj nuk mund të jetë më shumë se dyzet ditë sipas medh'hebit, sepse një barrë ka vetëm një lehonit, edhe nëse shtatzënia e saj ka shumë fëmijë.

Qëndrimi më i qëlluar është nëse asaj i përtërihet gjaku me fëmijën e dytë, ajo do të vazhdojë të jetë lehonë, edhe nëse e fillon edhe një herë nga fëmija e dytë. Si mund të thuhet atëherë që ky gjak nuk është asgjë, ndërkohë që ajo ka lindur dhe i ka zbritur gjak?!

Mbaroi dhe falënderimi i takon Allahut!
